



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 9**

Rrogozhinë, më 22.11.2023 ora 13 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.4181.Prot datë 16.11.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.8, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 02.11.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Shqyrtim i Paketës Fiskale 2024 për Bashkinë Rrogozhinë.
- 6- Raport nga Administratorët e Njësisve Administrative Kryevidh, Lekaj, Sinaballaj.
- 7- Raport nga Sektori i Auditit të Brendshëm.
- 8- Të ndryshme.

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Besnie Coraj, Saimir Cani, Mitat Daja, Fatbardha Sina, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Mukades Gixhari, Erind Tosku, Hekuran Xhani.

**Mungojnë :**

Ferdi Avdiu, Sokol Gosa, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

**Të ftuar :**



1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Shkelqim Gjoni - Administrator i Njesisë Administrative Kryevidh.
3. Altin Mema - Administrator i Njesisë Administrative Lekaj.
4. Valmira Troka - Administratore e Njesisë Administrative Gosë.
5. Mexhit Saliu - Administratore e Njesisë Administrative Sinaballaj.
6. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë.
7. Amarildo Duka - Sekretar i Përgjithshëm.
8. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
9. Fatmir Meçaj - Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Kulturës.
10. Orges Tosku - Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
11. Geraldo Gjini - Drejtori i Politikave Urbane.
12. Helidon Plaku - Drejtor i zyrës Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun.
13. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Ledian Hasani – Përgjegjës i Shërbimit Social.
16. Nuredin Tosku - Përgjegjës i Auditit të Brendshëm të Bashkisë.
17. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

#### **Drejtton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 14- Këshilltarë, z. Erind Tosku dhe z. Hekuran Xhani i bashkohen në vijim mbledhjes së KB-së.

### **HAPET MBLEDHJA**

**Mukades Gixhari .** Të nderuar këshilltarë! Përpara se të hapim këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë më lejoni të përkujtojmë humbjen e parakohshme të kolegut tonë Bajazit Thaçi. Ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje për të nderuar dhe respektuar kujtimin e anëtarit të dashur të Këshillit Bashkiak, i cili la pas një boshllëk të ndjeshëm në zemrat tona.



*Këshilltarët dhe pjesëmarrësit në mbledhje ngrihen në këmbë dhe mbajnë një minutë heshtje.*

... I paharruar qoftë gjithmonë kujtimi i të mirit Bajazit.

**Mukades Gixhari** . Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët:

Znj. Silvana Aliu, Z. Indrit Dedej, Znj. Lije Dedej, Znj. Besnie Coraj, Z. Saimir Cani, Z. Mitat Daja, Znj. Fatbardha Sina, Z. Altin Tosku, Znj. Gezime Met-hasani, Z. Lulzim Hasa, Znj. Alime Hoxha, Z. Enver Memolla, Znj. Fatmira Thartori, dhe Mukades Gixhari.

Lexojmë verifikimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për mbledhjen e datës 02.11.2023.

Vendim nr.28, datë 02.11.2023 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shpërndarjen në buxhet” është në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe aktit normativ nr.5, datë 18.10.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2023”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Prefekti Afrim Qendro.

Tani para se të kalojmë në rendin e ditës ju kam dërguar në grupin e këshillit në whatsapp si dhe i keni të fotokopjuara përpara projektvendimin “Mbi një shtesë në vendimin e këshillit Bashkiak nr.8, datë 30.06.2023 ‘Për miratimin e komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Rrogozhinë”, informacionin mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2023 të ardhur nga Njësia Administrative Gosë. Kemi të pranishëm dhe Përgjegjës të Elektrikut z. Edmond Memolla për të diskutuar mbi problematikat e ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë. Jeni dakord që t’i përfshijmë në rend dite dhe ti trajtojmë në pikën të ndryshme të rendit të ditës këto? Jeni dakord të nderuar Këshilltarë? E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim?

*- Miratohet me 14-vota pro, përfshirja në rend dite e projektvendimit, “Mbi një shtesë në vendimin e këshillit Bashkiak nr.8, datë 30.06.2023 ‘Për miratimin e komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Rrogozhinë”, informacioni mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2023 të ardhur nga Njësia Administrative Gosë, si dhe shqyrtimi i problematikave të ndërprerjes së energjisë elektrike nga përgjegjësi i OSHE dega Rrogozhinë.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, Kundra, Abstenim? Të gjithë pro miratohet.



*-Miratohet me 14 vota pro pika e parë e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën dy. Miratim i procesverbalit nr.8, datë 02.11.2023. E hedhim në votim. Pro, Kundra, Abstenim? Të gjithë pro miratohet.

*-Miratohet me 14 vota pro pika e dytë e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës miratim i projektvendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “. Do na relatojë përgjegjësi i shërbimit social z. Ledian Hasani. Përsëndetje z. Ledian!

**Ledian Hasani** . Përsëndetje të gjithëve! Në total janë 18 familje përfituese dhe fondi është 67 mijë lekë të reja.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje për z. Ledian në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Po z. Enver Memolla.

**Enver Memolla** . Unë nuk kam ndonjë gjë po thjesht kërkoj edhe nga Ledio që anën ligjore në komisionin e ekonomisë u diskutua në lidhje me rritjen e pagesave por që ana ligjore nuk ta lejon. Ja kishim kërkuar edhe ...mirëpo e kanë sjellë dhë është ok kjo pjesë. Pika e fundit e cakton qartë që thotë në bazë të përfitimit të ndihmës ekonomike, në këtë pjesë nuk ndërhyjmë dot për ta rritur.

**Ledian Hasani** . E kemi miratuar që në 2020, po të njëjtën gjë do miratojmë po i njëjti projektvendim.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë diskutim tjetër? E hedhim në votim? Kush është pro, kundra, abstenim? Të gjithë pro, miratohet.

*-Miratohet me 14 vota-pro, pika tre e rendit të ditës.*

**Vendim nr.29.** Miratohet me 14 vota pro projektvendimi i propozuar nga kryetari i Bashkisë me nr.4152,prot datë 14.11.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 4, miratimi i projektvendimit, “Për dhënien e ndihmës



ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me përgjegjësin e sektorit të shërbimit social z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani** . Në total janë 20 familje përfituese dhe fondi është 91 mijë lekë të reja.

**Indrit Dedej** . Sa më shumë aq më mirë.

**Ledian Hasani** . Edhe ju kur keni ndonjë familje që e shikoni që është në nevojë, t’i verifikojmë dokumentacionin edhe... Ne nuk kemi parë kujt krahu i përket fare.

**Enver Memolla** . Ne dje diskutuam edhe në komisionin e ekonomisë edhe Ledit ja thashë që këtu është një person për ndihmë ekonomike tek pjesa e ministrisë sociale. Do kërkoja pak transparencë për këtë emër që ta thojë ti vetë se pse do hasim në ndesh mbledhjet e tjera pse është ky emër dy herë.

**Ledian Hasani** . Pa merak fare, atëherë tek kriteret që kemi miratuar në 2020 janë po ato familje mund të jenë përfituese tek fondet e bashkisë edhe ato familje që janë në vështirësi ekonomike, i keni kriteret aty dmth tek ai dokumenti që ju solla dje.

**Enver Memolla** . Më shumë thashë për transparencë.

**Ledian Hasani** . Ajo është familje në vështirësi ekonomike, përgjegjësinë për atë e mbaj unë. Besoj ti e njeh atë?

**Enver Memolla** . E njoh prandaj thashë ta bëj transparente këtë pjesë, se e diskutuam këtë dje.

**Ledian Hasani** . Është Pasionata Muhamet Xhafa është edhe përfituese tek skema e ndihmës ekonomike edhe tek... kjo ka një fëmijë që e ka të sëmurë dhe nuk ka mundësi që ta ndjekë nëpër spitale apo në qendra shëndetësore.

**Silvana Aliu** . Po e kërkuam në mbledhjen e radhës dhe nuk e bëtë... punonjësi social ta marrë fëmijën të paktën t’i bëjë shërbim...

**Ledian Hasani** . Nuk kam qenë në mbledhje. Nuk kam qenë prezent se po të kisha qenë këtu të kisha thënë do e kisha bërë. Kjo është një ndihmë q ëajo do përfitojë tre muaj besoj që I dalin për të shkuar për t’i bërë shërbim vizita.



**Andi Proshka** . Rezart shihe pak këtë.

**Ledian Hasani** . I dalin për të kryer vizita jo me i kryer hallin asaj ajo mund të ketë halle shumë.

**Rezart Vogli** . Përshëndetje! Një sqarim për rastin Aishe Xhafa vajza e Bujarit dhe Pasionatës referuar dhe në drejtorinë e shërbimit social, po e referoi edhe znj. Silvana po ndiqet nga stafi i shërbimit social, vajza është me probleme të shëndetit dhe Bashkia Rrogozhinë edhe Shërbimi Social është në ndjekje të rastit. Faleminderit.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit. Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 14-vota pro pika 4 e rendit të ditës.*

**Vendim nr .30.** Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me nr.4057.prot datë 08.11.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.

**Mukades Gixhari** . Ju bëj me dije që mbledhjes ju bashkua z. Saimir Cani. Tani për procedurë, meqë kemi procesverbalin e komisionit të mandateve, i propozojmë Këshillit Bashkiak të deklarojë me vendim këshilli mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit të z. Bajazit Thaçi. Miratohet.

- *Miratohet me 14- vota pro, Propozimi i Komisionit të Mandateve për deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Bajazit Thaçi.*

**Vendim nr.31.** Miratohet me 14 vota pro, propozimi i komisionit të mandateve “Për deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Bajazit Thaçi”.

**Mukades Gixhari** . Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës. Shqyrtimi i paketës fiskale 2024. Fjala për drejtorin e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik z. Orges Tosku dhe si drejtorët e tjerë të jenë të gatshëm për plotësime sipas sektorit që mbulon secili. Z. Orges përshëndetje, fjala për ju.

**Orges Tosku** . Atëherë përshëndetje të gjithëve! Paketa fiskale normalisht hartohet në bazë të ligjeve në fuqi që miratohen nga qeveria qendrore dhe është në bashkëpunim me të gjithë drejtoritë e bashkisë Rrogozhinë, secila drejtori për ato tarifa për ato shërbime që ka. Taksa e



ndërtesës taksa e tokës bujqësore, ndikimit në infrastrukturë dhe taksat që mbliidhen nga agjentët tatimorë janë të përcaktuar nga këto ligje që miraton qeveria qëndrore. Edhe kategoritë që mund të përjashtohen nga një lloj takse siç janë pensionistët që përjashtohen nga taksa e ndërtesës janë të përcaktuara. Ne mund të vendosim për disa lehtësira si për tokën bujqësore dhe për taksën e ndërtesës gjë që e kemi aplikuar tek të gjithë njësitet administrative. Gjithashtu ne përcaktojmë nivelin e tarifave si për biznesin ashtu edhe për familjarët, paketa fiskale ka ecur po në gjurmët e paketave fiskale të viteve më parë duke ruajtur një politikë fiskale sa më të saktë në vitet më përpara. Disa ndryshime që ne kemi parashikuar, janë shtuar disa kategori specifike dhe më identifikuese për efekt tarifash, disa lloje biznesesh. Tarifa pastrami për bar kafe kemi menduar nga 10 mijë lekë të vjetra në 15 mijë lekë, fast food, piceri, bar bufe nga 15 mijë lekë ta çojmë në 20 mijë lekë. Disa tarifa nga drejtoria e politikave urbane dhe tarifa e vaditjes me rrjedhje mekanike nga 2 mijë lekë që ka qenë vjet e kemi parashikuar ta çojmë në 1 mijë lekë.

**Enver Memolla . Propozim?**

**Orges Tosku . Propozim.**

**Enver Memolla .** Është propozim i komisionit të ekonomisë kështu që nuk mund ta shprehësh atë pjesë, po nuk u mor vendimi këtu, duhet t'i përmbahesh çfarë ke tek relacioni.

**Mitat Daja .** Ne patëm faktikisht në orën 11 ishte dëgjesa publike që këshilli bashkiak duhet ta organizojë dhe...

**Enver Memolla .** Jo nuk e organizon këshilli bashkiak, dëgjesa publike është e bashkisë Rrogozhinë.

**Mitat Daja .** Më ler të mbaroj pastaj... ju po prisni “vdekjen e mbretit”... ju keni qenë në kafe duke pritur “vdekjen e mbretit”. Kishim dëgjese publike që e organizon këshilli bashkiak, dhe për fat të keq shumica e këshillit bashkiak nuk mori pjesë se nuk ishin të interesuar për paketën fiskale. Keni kohë të flisni që të gjithë do jua japë kohën kryetarja... Ato që morën pjesë diskutuan ato që kishin me diskutuar , kalimi i paketës fiskale sot ose diskutimi është i pamundur realisht sepse këtu flitet për taksat që do vendosen që do paguajnë njerëzit dhe një paketë fiskale e pakonsultuar me njerëzit nuk mund të jetë paketë e rregullt. Kështu që për ti dhënë dhe hapësirën e duhur të gjithëve dhe ato që harruan me ardhur sot se ishin duke pritur atë që thashë pak më përpara, mendoj që të lejmë një ditë tjetër, ku secili prej anëtarëve të këshillit sepse është detyrim ligjor në qoftë se nuk e dinë anëtarët e këshillit të marrin përfaqësuesit e tyre që i kanë votuar në paketën fiskale. Ndoshta mund të ketë dhe gjëra që janë të padrejta dhe mund të kenë



kërkesat e tyre që janë...Prandaj unë propozoj që paketa fiskale që është sot ne e shikojmë dhe e dëgjojmë drejtorin sepse ka ardhur këtu për të na folur por se nuk mund ta kalojmë dot sot pa e konsultuar njëherë me përfaqësuesit tanë që kemi, të flasim dhe ata fjalën e tyre se fundja dhe ne jemi përfaqësues të atyre dhe ata kanë të drejtën e tyre që të flasim. Dhe detyrimi ligjor është që ata të dëgohen derisa thotë dëgjesë publike është detyrim ligjor. Unë mendoj të lejmë një takim tjetër një dëgjesë publike më të zgjeruar, secili prej nesh të ftojë bizneset të ftojë njerëzit e vet që i ka për hallet e problemet e tyre që i kanë se ka shumë , i kemi të gjithë ne përfaqësuesit tanë dhe ta organizojmë një ditë tjetër. Mos vonohet shumë mendoj që propozim ose e vendosim të gjithë se unë një person jam, të Mërkurën tjetër që të mos zgjatemi shumë të bëhet një dëgjesë publike tjetër në një vend tjetër ku ne...

**Indrit Dedej** . Datën nuk e përcakton ti, e përcaktojmë ne kryetarët...

**Mitat Daja** . Thashë propozim... Pra të bëhet një gjë e tillë sepse ne...

**Orges Tosku** . Sot është për diskutim, ju në qoftë se keni propozime...

**Mitat Daja** . Ne diskutimin e kemi këtu por ti nuk më ke sjellë mua ... ke bashkëngjitur një raport ti ... unë do dëgjoj atë që do më thonë njerëzit mua dhe do sjell propozimin...

**Orges Tosku** . Por duhet ta kishe sjellë sot ...

**Mitat Daja** . Por jo se nuk e dija që duhet ta bëja unë mendoja që duhet ta bësh ti...

**Orges Tosku** . Unë them që për mua është kjo e drejtë...

**Mitat Daja** . Nuk është fare e drejtë se ti nuk më ke sjellë as ndryshime ... Ke pasur mbledhje komisioni dje ti?

**Orges Tosku** . Po.

**Mitat Daja** . Ku e ke ndryshimin që ke bërë tek mbledhja e komisionit taksat e komisionit nuk ma ke sjellë ndryshimin ku është?!

**Mukades Gixhari** . Po, z. Enver.

**Enver Memolla** . Për transparencë, duhet të dimë diçka zonja kryetare thjeshtë po ta bëj dhe





pyetje të drejtpërdrejtë. Dëgjuesën publike e ka organizuar Këshilli Bashkiak?

**Mukades Gixhari** . E ka thirrur Këshilli Bashkiak dhe është postuar dy herë tek faqja e këshillit.

*-Mbledhjes i bashkohet zëvendëskryetari i këshillit z. Erind Tosku në minutën e 17 të zhvillimit të mbledhjes.*

**Enver Memolla** . Unë nuk e di kështu se nuk kam njoftim zyrtar. Unë kryetari i grupit nuk e di. Di që Bashkia ka bërë thirrjen në faqen e saj zyrtare në mos gaboj për këtë datë por jo këshilli bashkiak. Nuk është këshilli bashkiak që bën dëgjesa publike është bashkia Rrogozhinë. Këshilli Bashkiak mund të jetë i ftuar mund të vijë dhe si qytetar por jo të bëjë këshilli bashkiak dëgjuesë publike. Unë skam bërë propozim nuk e di asnjë nga grupi ska bërë propozim për këtë pjesë dhe diçka tjetër në bisedat që kemi pasur bashkë të kam thënë që është jo e drejtë të bëhet mbledhja brenda ditës që është edhe dëgjesa sepse unë dua të shoh këtu cila është ajo gjë që është diskutuar në dëgjuesë publike.

*-Mbledhjes i bashkohet zëvendëskryetari i këshillit z. Hekuran Xhani në minutën e 19 të zhvillimit të mbledhjes.*

**Mukades Gixhari** . Është shqyrtim.

**Enver Memolla** . Patjetër është shqyrtim por në shqyrtim zotëria duhet të vinte dhe me pjesën çfarë ka thënë publiku, se prandaj është dëgjuesë publike të dëgjohet publiku dhe nuk e di kush ka qenë grupi i interesit nga biznesi i madh kush ka qenë, nga biznesi i vogël nga qytetarët kush ka qenë?! Se kjo është gjithë transparenca që të vi atje që e ka bërë këshilli bashkiak kjo është e palejueshme. Unë dhe Indriti nuk kemi informacion që këtë e bën këshilli bashkiak.

**Mitat Daja** . Atëherë sekretari i këshilli bashkiak tha që është detyrim ligjor që këshilli bashkiak ta organizojë dëgjuesën publike në mbledhjen që patëm. Konsultohuni me sekretarin e këshillit bashkiak dhe vendosni... mendoj unë e thashë propozimin tim.

**Ervis Shera** . Atëherë njoftimi është bërë tek faqja zyrtare e këshillit bashkiak që me datë 16 Tetor detyrimi që ka këshilli, ka bërë njoftimin tek stenda e bashkisë është bërë njoftimi gjithashtu , ju si këshilltarë se ju thatë në dëgjuesën publike që kishit takuar ...

**Indrit Dedej** . Me kë u konsultove ti sekretar që more vendim ti je për të mbajtur procesverbal nuk je për të marrë vendime.



**Ervis Shera** . Jam konsultuar unë se ne kemi ...

**Indrit Dedej** . Nuk je konsultuar as me mua si kryetar grupi, as me Verin as me kryetarin e bashkisë jo.

**Ervis Shera** . Ne kemi një program pune që e kemi miratuar në fund viti miratojmë paketën fiskale dhe buxhetin dhe që nga data 16 deri në datën sa jemi sot, ju në qoftë se do donit më herët apo më vonë kishit të gjithë kohën e duhur që të thonit ...

**Indrit Dedej** . Ju thatë që e ka mbledh këshilli.

**Ervis Shera** . Ju po përpiqeni që të ja veni fajin organizatorit tani kjo është gjëja ai që e ka organizuar e ka organizuar keq...

**Mitat Daja** . Nuk ka lidhje me gjetur fajtorin lidhje ka që të bëhet një gjë e mirë.

**Ervis Shera** . Po pra, ju thatë që ju kanë votuar 700 qytetarë, kam takuar biznese ...Po pse nuk i thatë hajdeni sot në orën 11 kemi dëgjese . Si përfaqësues i qytetarit kjo është detyra jote.

**Indrit Dedej** . Nuk është kryetar bashkie ai se nuk ka asgjë në dorë.

**Ervis Shera** . Kryetari i Bashkisë dhe administrata e bashkisë mund të organizojë dëgjese për hesapin e vet sa të dojë.

**Indrit Dedej** . Nga përvoja ime edhe në Durrës është bërë se unë jetoj në Durrës është bërë dëgjese publike. Kryetari i Bashkisë ka shkuar lagje më lagje edhe me urdhër...

**Ervis Shera** . Kryetari i Bashkisë, jo këshilli?

**Indrit Dedej** . Nuk ka gjë këshilli në dorë, ankesat që kam unë i parashtoj këtu.

**Ervis Shera** . Ne kemi njoftuar zyrtarisht, të gjithë ne duhej të njoftonim njëri tjetrin dhe të mos vinim ...

**Indrit Dedej** . Sekretar ne përfaqësojmë një komunitet...

**Ervis Shera** . Zotëria tha unë përfaqësoj 700 qytetarë, të sillte 50.



**Indrit Dedej .** Ai sjell ankesat nuk mund të shkojë një votues i tij të shkojë të takojë një x person ...

**Ervis Shera .** Dëgjo kjo ishte më mirë kështu sepse në qoftë se do i sillte administrata nëse do i sillte Kryetari ju do thonit pse i ka sjellë kryetari këto qytetarë... sillni ju qytetarë .

**Indrit Dedej .** Ne nuk kemi nevojë fare për dëgjese publike se ne nuk jemi në ekzekutiv që kemi një punë në dorë që mund të mbarojmë ...

**Ervis Shera .** Kemi thirrur administratën kemi thirrur drejtorat për këtë punë...

**Indrit Dedej .** Unë kam shkuar kam pasur ankesë nga qytetari kam shkuar dhe nuk kam gjetur zgjidhje kam shkuar vetë në bashki edhe nuk kam gjetur zgjidhje për një kanal.

**Ervis Shera .** Në rregull t'i shqyrtojmë tek dëgjesa të gjitha.

**Enver Memolla .** Për mua është diskutim mes Bashkisë dhe publikut jo midis Këshillit ... këshilli është vendimmarrës.

**Indrit Dedej .** Unë kam të drejtë të ngre një komision si këshill edhe i mbaroj punë qytetarit që nuk e pyes fare atë. Qytetari nuk gjen zgjidhje dhe dëgjuesen publike duhet ta bëni ju se ju jeni në shërbim të qytetarit, performanca juaj duhet të tregojë që bashkia po funksionon.

**Ervis Shera .** Duhet ta bëjë administrata dhe mos thërrasë këshillin fare?

**Mukades Gixhari .** Ta dëgjojmë pak drejtorin e financës z. Rezart Vogli.

**Indrit Dedej .** Të mblidheshin kryetarët e grupeve bashkë me kryetarin bashkë me kryetarin e bashkisë , kolegji i kryetarëve që nuk është mbledhur asnjëherë është e detyrueshme të mblidhet apo jo? Edhe ne vendosim ecurinë e vazhdimësisë të bashkisë, apo nuk është kështu? Thuaj njëherë ti sekretar ke mbajtur protokoll se u mbledh kolegji i kryetarëve? Atëherë me çfarë urdhri e more ti, ne nuk u mblodhëm këtë mbledhje do e bëjë këshilli, se do e bëjmë ne?

**Ervis Shera .** Kemi miratuar një kalendar që në fillim viti... që në fund vitit që shkoi dhe ju është përcjellëdhe ju të gjithëve me email.

**Enver Memolla .** Kryetare tani paketën fiskale e harton bashkia Rrogozhinë apo Këshilli Bashkiak?



**Orges Tosku .** Bashkia.

**Enver Memolla .** Se nuk po merremi vesh se në bazë të dëgjesave publike do miratohet pjesa e ndryshimeve. Këto vijnë nga populli këto vijnë nga pjesa e komisionit të ekonomisë që kemi kërkuar dhe ne tre ndryshimet tona për pjesën që duam të bëjmë. Por ama të thërrasë këshilli bashkiak nuk ka të drejtë nuk ka ndodhur ndonjëherë këshilli bashkiak... Këshilli bashkiak është përfaqësues dhe unë vi si përfaqësues si popull për të dëgjuar.

**Mukades Gixhari .** Ta dëgjojmë pak Rezartin ka qenë në një trajnim dje.

**Rezart Vogli .** E citova dhe pak më parë në takimin e orës 11:00 të dëgjesës publike. Ne dje ishim të ftuar nga ana e Prefektit të qarkut Tiranë përfaqësues ishin: Kryetarja e Këshillit, Sekretari i Këshillit drejtori i financave. Drejtori i taksave dhe drejtori juridik. Jo më kot ishin këto drejtori të ftuara atje se jemi drejtori që kemi më shumë projektvendime dhe kalojmë më shumë shkresa në këshill bashkiak. Takimi kishte të bënte me ligjshmërinë dhe me detyrat që ka këshilli bashkiak dhe administrata e bashkisë Rrogozhinë. Ndër të tjera u citua dëgjesat publike thirren nga anëtarët e këshillit bashkiak, administrate ftohet nga këshilli bashkiak të japë informacion dhe të informojë publikun për paketën fiskale dhe për buxhetin afatmesëm. Në këtë mbledhje që u zhvillua dje ishin të ftuar edhe përfaqësues të projektit Bashki të Forta dmth është projekti që është organizator i funksionimit të mirë të këshillit bashkiak ju keni pasur dhe një trajnim nga ana e tyre mesa di unë para pak kohësh për detyrat dhe funksionet e këshillit bashkiak dhe Prefekti i Qarkut jo më kot e organizoi takimin. Është detyrë e këshillit bashkiak të thërrasë dëgjesën publike, është detyrë e administratës së bashkisë Rrogozhinë të raportojë për çdo lek të fondeve publike.

**Erind Tosku .** Të bëj një pyetje Rez? Pse çuditërisht sot paska ardhur gjithë kjo administratë qenka mbushur kaq shumë plot këshilli bashkiak?! Sa herë i kemi thirrur drejtorat dhe nuk na kanë ardhur, çfarë ndryshoi sot pse qenka dëgjesë publike kanë ardhur sot? Ne kemi kërkuar për të dhënë shpjegime shumë drejtora këtu dhe nuk na kanë ardhur.

**Enver Memolla .** Kryetare me leje? Në emër të grupit të PS kërkoj që seanca të ndërpritet për 10 minuta nuk e di nëse kolegu është dakord, të bëhet mbledhja e kolegjit të kryetarëve.

**Indrit Dedej .** Dakord.

*-Mbledhja ndërpritet për 10 minuta. Pas pushimit mbledhja rifillon me fjalën e Kryetares si më poshtë.*



**Mukades Gixhari** . Atëherë vazhdojmë po me pikën 5, për shqyrtimin e paketës fiskale. Ndonjë pyetje për drejtorin?

**Alime Hoxha** . Përsëritje ! Atëherë dje nga mbledhja e komisionit të ekonomisë pasi dëgjua drejtorin e taksave, të financës dhe drejtorin e urbanistikës që ishin të pranishëm në mbledhjen e këshillit. Konstatuam që tarifën siç na u tha edhe nga drejtuesi nuk kanë ndryshuar në përgjithësi. Të gjithë tarifën që ka për detyrim të vendosen nga këshilli bashkiak janë të pandryshuara nga viti paraardhës përveç këtyre tarifave që ishin shtuar tek pjesa e urbanistikës tani ky është një detyrim sipas drejtorit të urbanistikës na u tha që duhet të vendosim disa tarifa për hapjen e dosjeve për marrjen e dokumentave kjo mbetet për t'u diskutuar. Dhe bëmë dy propozime për një taksë që është një taksë prej 300 lekësh tarifë 3 mijë lekë të vjetra për zonat rurale për njësitë administrative në të cilën sipas drejtorit të taksave përfshin të gjitha shërbimet. Pra në qoftë se një qytetar do vijë të marrë shërbime në bashkinë e Rrogozhinës nuk i paguan kur i merr por në total për një vit paguan një tarifë prej 300 lekësh apo 3 mijë lekësh të vjetra në vit. Dhe tjetër propozim që bëmë ishte për ujitjen me rrjedhje mekanike që ishte 2 mijë lekë për hektar, po flasim me të reja 2 mijë lekë të reja për hektar dhe 2 mijë lekë të vjetra për dynym me rrjedhje mekanike. Meqenëse për rrjedhjen e lirë kjo tarifë është 3 mijë lekë duke llogaritur edhe koston që ka fermeri me naftën që të vendosi pompë për rrjedhjen mekanike të ketë pompë që punon me naftë menduam që kjo tarifë të ulet në 1 mijë lekë të vjetra. Këto ishin propozimet e komisionit të ekonomisë.

**Fatmira Thartori** . Unë doja të bëja një pyetje. Atëherë nga komisioni dëgjua që ka rritje të taksës së banesës...

**Orges Tosku** . Janë disa tarifa nga drejtoria e urbanistikës për hapje dosje, nëse ti do të bësh restaurime tek shtëpia pllaka bojë...

**Fatmira Thartori** . Pse janë këto shtesa dhe nuk mund të jemi tek ajo pjesa që nuk mund të jenë shtesa apo pluse sepse bëhet fjalë për qytetarët e zonës tonë që nuk janë shumë të pasur, janë dhe zonë rurale nuk mund të themi që janë zonë urbane.

**Amarildo Duka** . Janë vënë tarifa për nenin 6?

**Orges Tosku** . Për deklaratë paraprake.

**Fatmira Thartori** . Ne duhet të jemi të gjithë koshientë si këshill bashkiak që nuk duhet të ngrihen këto tarifa.



**Orges Tosku** . Nga 4 mijë lekë të vjetra (në fakt është të reja) shkon 5 mijë lekë se normalisht derisa krijon mbetje.

**Fatmira Thartori** . Prap është...ne duhet të jemi tek kjo pjesa...

**Erind Tosku** . Po taksa për hapësirën që zej në bizneset, hapësira publike.

**Orges Tosku** . Po është 60 lekë në muaj.

**Erind Tosku** . Nuk ka abuzime?

**Orges Tosku** . Ato që kanë paguajnë.

**Indrit Dedej** . Për të bërë një restaurim brenda shtëpisë duhet të paguaj taksë personi?

**Orges Tosku** . Duhet të paguajë tarifë 5 mijë lekë të reja.

**Indrit Dedej** . Durrësi nuk e ka.

**Amarildo Duka** . Jo nuk ekziston kjo për restaurime brenda shtëpisë.

**Indrit Dedej** . Të bësh një dritare duhet të paguash një tarifë që të bësh një dritare?

**Enver Memolla** . Për restaurime është shprehur dje, për riparim restaurim dritare dyer për hapje dosje.

**Fatmira Thartori** . Po mirë se janë po pse duhet t'i ngrejme?

**Geraldo Gjini** . Disa Bashki e kanë disa jo, ne e kemi pasur 4 mijë lekë të vjetra duke qenë se këtu në Rrogozhinë pjesa më e madhe nuk kanë dokumentacion i bie që të mos e bëjnë fare shtëpinë. Ne kemi proceduar me këto, do bëjë suvatime tek shtëpia, kapotë apo një gjë kemi marrë vërtetim nga njësitë që është banor apo posedon një shtëpi se si rregull duhet të ketë një dokument pronësie që ti të kryesh punime në shtëpi, që ta bëjmë çdo gjë të rregullt sipas ligjit.

**Amarildo Duka** . Është për nenin 6?

**Geraldo Gjini** . Për 6-ën.



**Amarildo Duka** . Për 6-ën është thjeshtë njoftim nuk ka nevojë për...

**Geraldo Gjini** . Tirana nuk e ka.

**Silvana Aliu** . Nuk e ka Tirana që është, imagjino...

**Orges Tosku** . Këto grumbullime do pastrohen, ky grumbullimi ka kosto...çohen tek vend depozitimi dhe paguhen atje me kilogram me ton, këtë e paguan Bashkia.

**Indrit Dedej** . Ç'punë ka qytetari të paguajë lejen që do mari leje për një dritare.

**Orges Tosku** . Është gjë tjetër kjo.

**Erind Tosku** . Mos bëni ndonjë lapsus.

**Orges Tosku** . Nuk është lapsus kjo është tarifë, bashkia ka të drejtë të vendosi çdo lloj tarife. Tirana ka tarifë për të mbajtur dyqanin 24 orë hapur për shembull, se atë lloj jete biznesi ka, ne nuk kemi. Nuk është tarifë është ligj.

**Indrit Dedej** . Të mbash dyqanin si thotë ky do licensë më vete, që të marrësh për punime të brendshme unë kam bërë se kam pagur.

**Orges Tosku** . Nuk është e thënë edhe Durrësi tarifën e pastrimit për familjarë e ka 40 mijë lekë, ne e kemi 20 mijë lekë. Ta bëjmë sa Durrësi?

**Indrit Dedej** . Se di atë.

**Silvana Aliu** . Nivelin e jetesës si Durrësi e kemi?

**Orges Tosku** . Me i hyrë asaj pastaj...

**Enver Memolla** . Po këtu merret se merret niveli bazë për jetesë sa është kosto për jetesë...Durrësin e ke nivel tjetër Bashkie e ke nivel i tretë nuk e ke nivel i dytë e të parë. Këtu nis dhe niveli i taksimit nga qeveria qendrore edhe pjesë e tarifave nuk mund të kemi tarifa më të larta se taksat vendosur me VKM-në e qeverisë, se niveli i bashkive është ndryshe.

**Indrit Dedej** . Ti mundohesh të ngresh taksat edhe biznesit të vogël ja ka ngritur taksat.



**Orges Tosku** . Jo nuk i ngrejmë ne taksat o Indrit, taksat vijnë nga qeveria vijnë fikse, ne ngrejmë vetëm tarifat me vendim të këshillit bashkiak ne ngrejmë vetëm tarifat.

**Indrit Dedej** . Nga 100 mijë lekë e ke bërë 150 mijë lekë.

**Orges Tosku** . Është tarifë, jo taksë.

**Indrit Dedej** . Sa biznese ke, nuk po ka njerëz fare...

**Andi Proshka** . Indrit prandaj jemi në fazë shqyrtimi jemi në bashkëbisedim...

**Indrit Dedej** . E dyta ju nuk jeni të zotë të mblidhni taksat? Ju keni dal me vitet e kaluara keni dalur skëterrë 300 milion lekë pa mbledhur taksa nuk jeni të aftë t'i mblidhni.

**Orges Tosku** . Nuk janë falur ato një nga ato debitorë je dhe ti.

**Indrit Dedej** . Nuk je i aftë me i mbledhur pra.

**Orges Tosku** . Të gjithë procedurat janë bërë.

**Indrit Dedej** . Unë këtë po them pra, nuk je i aftë t'i mbledhësh.

**Orges Tosku** . Procedurat ligjore janë bërë, debitorë pastaj normalisht do krijohen.

**Enver Memolla** . Tani një pyetje retorike më fal për ndërprerjen...

**Indrit Dedej** . Sepse unë kur jam debitor duhet të më mbyllësh biznesin.

**Orges Tosku** . Nuk ekziston, ke mbyll biznesin ti kemi bërë bllokim llogarie e të gjithë masat tjera janë marrë ndaj teje.

**Indrit Dedej** . Tani ti mos ma lër mua biznesin nuk paguan hajt se është shoku im, mbylle.

**Orges Tosku** . Ne kemi disa masa dhe këto masa janë marrë për të gjithë debitorët.

**Amarildo Duka** . Me strukturën e re do bëhet edhe një sektor më vete sektori i borxhit që do merret vetëm me këtë pjesë.





**Mukades Gixhari** . Pyetje tjetër në lidhje me këtë pjesë.

**Orges Tosku** . Duhet me theksuar që Bashkia Rrogozhinë ka ndër tarifatat më të ulëta në rang të gjithë Bashkive tjera. Të marrësh një Bashki në kategori me ne nuk i ka këto tarifa.

**Amarildo Duka** . Meqenëse kemi bregdetin ta rrisim pak.

**Indrit Dedej** . Ta rrisim por ta përcaktojmë. Ai i Sinaballaj nuk mund të paguajë sa ai në bregdet.

**Gezime Met-hasani** . Për tarifën e pastrimit ne në Sinaballaj nuk kemi asgjë çfarë do paguajmë 6 mijë lekë kur nuk ka asnjë kosh e asgjë, apo gjelbërimi, apo ...

**Altin Tosku** . Gjelbërim ke plepa sa të duash.

**Gezime Met-hasani** . Nuk ke asgjë pse ta paguaj unë këtë 6 mijë, 8 mijë as ndriçim asgjë këtë kisha.

**Erind Tosku** . Faktikisht ajo që tha Indriti pse nuk i mblidhni ju është shumë e vështirë, normalisht është shumë e vështirë sepse do dal tek ajo që tha Gezimja në Sinaballaj i njëjti problem, Gosa e vogël i njëjti problem fshatrat i njëjti problem. Pra unë nuk kam ndriçim ... nuk po e përmend Rrogozhinën se është pak më ndryshe se sa fshatrat, rrugët nuk kanë as mirëmbajtje e asgjë plehrat hidhen rrugës. Tani hajde se po vazhdojmë po i paguajmë taksat por nuk kam parë gjë asnjë ndryshim asnjë masë...

**Andi Proshka** . Tani shërbimi zero nuk është...

**Erind Tosku** . Zero është sepse nuk ka kosh, ai nuk ka ndriçim.

**Silvana Aliu** . Nëse një lagje e Rrogozhinës nuk arrin të pastrohet shërbimi është zero mos prit për fshatrat.

**Andi Proshka** . Kush lagje nuk është pastruar?

**Silvana Aliu** . Ke rreth stadiumit e ke skandal...

**Andi Proshka** . Tek rruga po që është e pashtuar por jo se ka mbeturina. Tek stadiumi janë dy kosha.



**Silvana Aliu** . Mbaron ndeshja edhe rruga e stadiumit është me mbeturina, fusha përballë pallatit tek lagja ku jemi ne sikur të fusin ato gratë edhe po ti thuash a mund ta pastrosh?-Nuk më kanë dhënë urdhër. Shërbimi është zero nëse për ju funksionon që pastrimi do jetë vetëm rrugët kryesore...

**Indrit Dedej** . Ndoshta nuk je në dijeni ti si titullar.

**Andi Proshka** . Edhe ju nëse keni të tilla probleme vini dhe i trajtoni.

**Erind Tosku** . Jemi të gjithë në Rrogozhinë kalojmë pesë herë tek e njëjta rrugë, po të njëjtat problematika i shohin të gjithë.

**Andi Proshka** . Tani nuk besoj që Rrogozhina është një nga këto.

**Erind Tosku** . U kapa tek fjala që the po të vini ju e të na thoni, dakord ju e shikoni dhe vet se kaloni përditë nuk merni dot punonjës in tuaj që e keni vartës shiko se filan vend është problematika se keni bërë ...

**Andi Proshka** . E kemi bërë ...

**Erind Tosku** . Në rregull kërkoj ndjesë unë, se kam parë.

**Silvana Aliu** . Dmth ti quan pastrim kur vjen makina vetëm në darkë mërr vetëm ato, dhe ajo quhet pastrim?

**Andi Proshka** . Jo, edhe punonjës it e shërbimeve janë gjithmonë të ...

**Silvana Aliu** . Absolutisht nuk i kam parë ndonjëherë në rrugë, megjithatë...

**Indrit Dedej** . Po sikur të bëjmë një amnisti, sikur ulni 10% të tatimeve të prapambetura ...

**Amarildo Duka** . Duhet parë dhe baza ligjore funksionon apo jo.

**Orges Tosku** . Të bëjë një aktmarrëveshje t'i paguajë avash avash.

**Enver Memolla** . Këtë që kam propozuar unë që kam thënë siç e ka korporata e OSHE-së që paguan muajin e radhës paguan dhe një përqindje... edhe ul borxhin edhe paguan vitin aktual.



**Indrit Dedej** . Baza ligjore është se unë e kam dëgjuar nga dikush.

**Orges Tosku** . Pastaj i bie që ai që ka paguar pastaj ta subvencionosh, se çfarë kuptimi ka?! Po rri dhe unë 5 vjet dhe hajt se po më falen...

**Indrit Dedej** . Më mirë të mbledhësh se sa mos të mbledhësh fare.

**Mitat Daja** . Borxhi është borxh do paguhet.

**Orges Tosku** . Unë i kam paguar çfarë do bësh do më subvencionosh? Nuk bëjmë dot amnisti.

**Enver Memolla** . Unë para sa kohësh kam bërë një propozim, jo për të ulur borxhin por për të ja marrë në mënyrë tjetër paguaj një vit të prapambetur dhe vitin aktual, vetëm kështu mund ta zgjidhësh borxhin pa e shtuar.

**Orges Tosku** . Bëjmë marrëveshje me këste. Që të falim ne nuk kemi tagër ligjor që të faliom detyrimet e prapambetura për aktmarrëveshje jemi të hapur si me bizneset edhe me familjarët edhe është proceduar.

**Indrit Dedej** . Ai që ka taksa toke psh ka vite që nuk ka paguar...

**Altin Tosku** . Nuk i paguan se nuk ka kanalizim çfarë do paguajë ai?!

**Amarildo Duka** . Faktikisht është një ligj që kur kalon afati dy vjeçar për mbledhjen e taksave mund të bëjë kërkesë për heqjen e gjobave kamatvonesave...

**Orges Tosku** . Duhet me e parë mirë të rrijmë të gjithë nga dy vjet vitin e tretë na e fal këshilli. Është në Itali ka taksën e ndërtesës kthehet pas tre vjetësh të ja fshijmë ne? Hajde se po rrijmë të gjithë këtu mos paguajmë asgjë dhe vitin e tretë me vendim këshilli.

**Indrit Dedej** . Nuk ka shans edhe në Hënë të shkojë ai pa ardhur me marrë një shkresë në bashki.

**Altin Mema** . Po duhet me gjetur bazën ligjore Indrit.

**Amarildo Duka** . Po presim të bëjmë një kontratë me ujësjellësin që taksat e ndërtesave tokave bujqësore t'i marrim nga ujësjellësi.



**Indrit Dedej** . Kushdo të jetë jashtë pa një hall në bashki nuk ka shans edhe pas 15 vitesh t'i paguajë të gjithë detyrimet.

**Alime Hoxha** . Meqenëse jemi këtu ne e propozojmë njëherë për këtë taksën 3 mijë lekë e heqim për të gjithë kategoritë nëpër fshatra nëpër zonat rurale dhe të rishikohet për taksën e gjelbërimit dhe pastrimit. Megjithatë edhe në qoftë se ajo tarifë nuk do hiqet nuk kanë pastrim nuk kanë gjelbërim, të paktën dy punëtorë me pastruar ato rrugët a mund të gjenden? Se andej janë rrugët që i kanë mbushur ferrat.

**Orges Tosku** . Kur është mundësia kanë shkuar.

**Alime Hoxha** . Tani më fal ju e sillni këtë tarifë për pastrimin nuk e ofroni këtë shërbim pastrimin, e mblidhni për ndriçimin nuk ja ofroni, të paktën mbuloni këtë shërbimin tjetër dhe mbulojmë mënyrën se si po e merr këtë taksë.

**Orges Tosku** . Në dijeninë time ka punëtorë sezonalë që shkojnë në zonar ku është nevoja.

**Alime Hoxha** . Ju e dini teorikisht por praktikisht sa është bërë sepse ne i kemi parë që të gjitha rrugët dhe ajo që është më kryesore rrugët që të çojnë në bregdet në kohën e sezonit i kanë mbuluar ferrat unë e kam ngritur dhe herë tjetër këtë çështje.

**Olsi Dranga** . Nuk është e vërtetë.

**Alime Hoxha** . Tani ne kemi kaluar aty i kemi parë.

**Olsi Dranga** . Për të dyja rrugët e bregdetit edhe të Vilë Bashtovës edhe të Spillesë është kompani e kontraktuar nga ARSH -ja e cila kryen shërbimin e mirëmbajtjes në ato rrugë.

**Erind Tosku** . Pastrimin apo mirëmbajtjen?

**Olsi Dranga** . Pastrimin e bëjmë ne.

**Erind Tosku** . Vetëm për pastrimin po thonte zysha.

**Olsi Dranga** . Edhe pastrimin e ka ARRSH-ja. Mos e ngatërrojmë shërbim pastrimin e bëjmë ne.

**Fatmira Thartori** . Ju që keni ardhur këtu drejtora, a mbani shënime për këto që po thotë



kryetarja e komisionit të ekonomisë? Pra propozimet që po jep ajo ju duhet t’i mbani shënim këto që radhën tjetër kur ju të na sillni paketën fiskale që ne ta miratojmë të jenë në rregull këto konform të gjitha gjërave që thotë zonja.

**Alime Hoxha** . Edhe një propozim tjetër ne propozojmë që edhe ajo tarifa ...

**Mitat Daja** . Zonja kryetare do i japim drejtim apo do e bëjmë... sepse vazhdoi si muhabet kafeje.

**Silvana Aliu** . Punonjësit e administratës ta heqin këtë që punëtori shkon kur ka mundësi e detyron ti...

**Orges Tosku** . Kur është nevoja...

**Silvana Aliu** . Si kur është nevoja pastrimi rrugët të paktën dy herë në javë.

**Andi Proshka** . Ato janë gjithmonë në shërbim të qytetit por sipas nevojave më emergjente futen nëpër zona të caktuara jo se... janë gjithmonë në shërbim.

**Indrit Dedej** . T’i bëj një pyetje këtij drejtorit të shërbimeve, më trego një foto që ke dalë me punëtorët e tu.

**Olsi Dranga** . Mos u shqetëso, duke pastruar letra ...po.

**Silvana Aliu** . Jo atë që ke bërë në Spille që ke qenë me fushatë...

**Olsi Dranga** . Të lutem do foton, t’i tregoj foton...

**Mitat Daja** . Tani po diskutojmë paketën fiskale apo po diskutojmë ato problemet... letrat që mbledh administrata, u bë muhabet kafeje po na ofendoni ne të tjerëve që rrijmë këtu.

**Altin Tosku** . Nuk jam dakord me rritjen e tarifës së tabelës ose të ngrihen të gjitha ose nuk më duket e arsyeshme.

**Orges Tosku** . Taksa e tabelës vjen e përcaktuar nuk është se e vendosim ne.

**Altin Tosku** . Ajo që ngrihej 50 mijë lekë çfarë ishte ajo?



**Orges Tosku** . Tarifë pastrimi ... kështu e kemi menduar ne.

**Altin Tosku** . Arsyeja pse e keni menduar kështu, jepni shpjegime?

**Orges Tosku** . Duke qenë se janë edhe biznese, që kanë mbetje më shumë se tjerat...

**Altin Tosku** . Kush ka më shumë se tjerat?

**Orges Tosku** . Baret, kafetë.

**Altin Tosku** . Çfarë kanë baret vetëm kafe kanë, kanë kanaçe ato i marrin ... Çfarë kanë baret?! Po e bëni sikur kanë baret kanë mbeturina plehra...

**Orges Tosku** . Ne kështu e kemi menduar...

**Altin Tosku** . E mendoni ju por nuk është ashtu ose t'i ngrehen të gjithëve, unë nuk jam dakord me këtë.

**Orges Tosku** . Këto e kanë pasur më të ultën janë barazuar me tjerët.

**Altin Tosku** . E bëni sa të doni unë po flas në mënyrë të përgjithshme nuk është e thënë vetëm për këtë pjesë.

**Enver Memolla** . Në vazhden e asaj që tha dhe kolegu tjetër një pyetje kam se po thoni që mund të ketë më shumë mbetje. Pyetja që lind është në moment që ka më shumë mbetje pastrimi bëhet njëherë në ditë tani do bëhet dy herë apo tre herë në ditë apo do vazhdojë po i njëjti ritëm?

**Orges Tosku** . Se di, unë e di që shërbimi është bërë.

**Enver Memolla** . Atëherë i bie që shërbimi është bërë dhe tarifa nuk duhet të rritet. Në qoftë se është kjo është bërë nga dje ose nga sot e tutje me kaq tarifë pse mos bëhet edhe më mbrapa po me këtë tarifë që ka qenë?

**Orges Tosku** . Këto lloj biznesesh janë barazuar dhe me tjerët se ka qenë ndër më të ulëtat 100 mijë lekë në vit bar kafeja.

**Altin Tosku** . Atëherë kjo është arsyeja që do i barazojmë me të tjerat jo t'i rritet këtyre.



**Erind Tosku** . Çfarë studimi keni bërë ju si Bashki nuk po them vetëm ju si drejtori, që ky zëri nga studimi që keni bërë ju paska dalë Rrogozhina me shumë mbetje e të gjithë gjërat tjera që duhet të rritet ky fond kjo taksë dmth që ne ta menaxhojmë situatën që na ka dalë jashtë kontrollit.

**Orges Tosku** . Duke qenë se bizneset e kanë pasur tarifën nga më të ulëtat janë barazuar edhe me tjerët.

**Altin Tosku** . Atëherë kjo mund të jetë nga arsyet më të rregullta, janë barazuar me tjerat.

**Erind Tosku** . Kur është mundësia për të rritur hajde se po e rrisim por si nuk ka një arsye se nuk po dëgjoj një arsye që të jem i bindur... po bëjnë bizneset më shumë po kush biznese? Çfarë mbetjesh po bëjnë, a nuk kemi mjet që t'i marrim këto mbetje, hajde ta rrisim gjejmë mjetin por nuk po e kuptojmë çfarë, pse.

**Enver Memolla** . Prandaj unë po them nuk ka arritur me këtë shërbim të pastrohet e gjithë, ka ngelur aty sepse makina me kaq volum nuk vjen dot dy herë ? Arsyetimi vjen në bazë të fakteve.

**Orges Tosku** . Ka qenë lloji i bizneseve më të ulëta.

**Enver Memolla** . Atëherë ky është ndryshim relacioni sepse ndryshe kur thua do e barazoj me pjesën tjetër do e bëj standard siç ishte dhe unifikimi i ujit para dy muajsh, ndryshe kur thua ka më shumë mbetje duhen më shumë lekë për të pastruar.

**Orges Tosku** . Edhe pjesa e mbetjeve dihet...

**Amarildo Duka** . Duke qenë se u bë dhe rruga e re e Spillesë psh, parashikohet që numri i turistëve të rritet, baret dhe restorantet që janë në atë zonë...

**Altin Tosku** . Atëherë është për pjesën atje jo për pjesën këtu.

**Enver Memolla** . Atëherë specifikojë është për të gjithë zonën?

**Amarildo Duka** . Shumica e bizneseve në atë zonë janë.

**Enver Memolla** . Ndryshe ai që ka restorant atje.



**Amarildo Duka** . Duke qenë se atje ka mbetje peshku duhet pastruar më shpesh.

**Enver Memolla** . Dakord jam për pjesën e bregdetit nuk jam kundër por tek relacioni po biem në kontradiktë me drejtorin se ndryshe kur rritet tonazhi për të bërë pastrimin dhe për ta çuar në incinerator dhe ndryshe kur thuhet dua ta barazoj është tjetër gjë.

**Orges Tosku** . 5 mijë lekë të reja në vit është. Është për të gjithë bashkinë nuk është vetëm për pjesën e...

**Indrit Dedej** . Nuk ja vlen që ta ngresh në qoftë se e përcaktojmë pjesën e plazhit dhe turizmit po e ngrejmë për sa mban ajo lodhja që kanë për dy muaj.

**Amarildo Duka** . Dakord po numri i njerëzve që kalojnë për dy muaj aty është shumë më i lartë...

**Altin Tosku** . Do i marrësh taksë ti atij.

**Enver Memolla** . Rritja e taksave e përmirëson shërbimin apo jo unë këtë dua të di? Sepse në qoftë se me rritjen e taksave do vijë po një herë apo një herë në tre ditë tek lagja mbi stacionin e trenit kjo është gjë tjetër pastaj. Unë këtu e kam tarifa e përcakton shërbimin?

**Mitat Daja** . Nuk e përcakton shërbimin tarifa është tarifë shërbimi do ofrohet në bazë të kontratës që bën ajo...

**Enver Memolla** . Unë këtë po kërkoj.

**Mitat Daja** . Ajo është për taksat o Ver, nuk është për shërbimet, shërbimet duheët të flasësh me drejtorin e shërbimeve më vonë. Ai thotë taksën e kam parë të arsyeshme të jetë kështu, arsyetimi atij për tarifën. Nuk ta jep drejtori i taksave përgjigjen për këtë punë se po xhirojmë po në vend.

**Andi Proshka** . Paketa fiskale përmbush objektivat e bashkisë aty ku ka probleme do shtohet një punëtor një kosh apo për çfarë ka nevojë bashkia, këtë po thotë edhe Gesi por ju nuk po e keni të qartë.

**Enver Memolla** . Në përgjigjen e Gesit e kam dhe dje tek komisioni i ekonomisë e kam dhe sot që thotë dua ta barazoj me të tjerat nuk po më thotë që në bazë të taksës rritet tarifa për të kryer





shërbimin, për të shtuar punonjësin dhe për të mbuluar gjithë zonën.

**Mitat Daja** . Tarifat janë vendosur i ka menduar zotëria që të jenë të tilla, unë propozimin e bëra për të bërë një dëgjese tjetër publike, pavarësisht se jam i vetëm dhe nuk kam mbështetje unë hedh si propozim të mendohet të arsyetohet, të shikohet dhe të jepen propozimet e duhura. Ose të bëjmë propozim për efikasitetin e mbledhjes së taksave, të diskutohet dhe buxheti të bëhen të gjithë këto punë. Lejmë një ditë tjetër që paketa fiskale është mirë që të dëgjohet nga njerëzit është mirë që të ketë transparencë dhe është mirë që njerëzit të japin arsyetimet e tyre për tarifatat që vendosen në bashkinë e Rrogozhinës, qoftë nga Sinaballaj, qoftë nga Kryevidhi, apo fshati më i fundit që është në Bashkinë e Rrogozhinës. Pra ideja është mos t'i bëjmë gjërat kështu rutinë thjeshtë hajde ta kalojmë apo thjeshtë hajde ta propozojmë. Mendimet tona janë të vakëta nëse ne nuk e zgjerojmë rrethin tonë të mendimit me njerëzit dhe gjykimin që kanë njerëzit. Ky është propozim unë mendoj ta hedhim në votë, e pranuat mirë po nuk e pranuat është puna juaj pastaj. Unë mendoj që ky propozim të hidhet në votë se kam të drejtën ta propozoj që të hidhet në votë që ne të bëjmë dëgjese publike tjetër për paketën fiskale.

**Indrit Dedej** . Unë jam i mendimit që dëgjese publike pak a shumë jemi dhe Live tani ne u keqkuptuam ata po na ndjekin...

**Mitat Daja** . Mirë ti jep mendimin tënd thuaj kundërshtojë. Zysh propozoj ta hedhim në votë edhe e kundërshtojmë nuk jemi dakord.

**Indrit Dedej** . Të mbaroj mendimin unë dhe e hedhim në votë, kurse për paketën kemi nevojë për më gjatë. Tani për dëgjese publike tani populli ka dhe hallet e vitit të ri, ka problemet me festat me ullishtat.

**Mukades Gixhari** . Tjetër koment në lidhje me paketën?

**Enver Memolla** . Vetëm pikat që janë lënë të merren parasysh që të bëhen ndryshimet.

**Alime Hoxha** . Atëherë për paketën këto ishin, kemi diskutime tjera u mbyllën diskutimet kemi ato propozimet që kemi dhënë shpresojmë të merren parasysh propozimet që ne kemi dhënë. Megjithatë secili anëtar këshilli ka të drejtën të takojë persona qofshin biznese, qofshin persona fizikë të jua marrë mendimin dhe ti sjellë ato shqetësime që ato kanë këtu.

**Mitat Daja** . Edhe për ta hedhur në propozim duhet me marrë mendimet e kryetarëve. Hidhe propozimin në votim le ta kundërshtojnë.



**Alime Hoxha** . Nuk janë dakord kryetarët.

**Mitat Daja** . Hidhe në votim, kundërshtojeni mbylleni.

**Mukades Gixhari** . Kush është dakord me propozimin e z. Mitat Daja? Për të bërë një dëgjese tjetër publike? E hedhim në votim. Pro? Pro dhe unë jam pro dhe vota ime shkon pro. Miratohet.

**Enver Memolla** . Sa vota janë?

**Mukades Gixhari** . Edhe njëherë t'i numërojmë, si i patët ngritur. Një, dy... dhjetë.

**Enver Memolla** . Dhjetë?

**Fatmira Thartori** . Dhjetë sepse i bie që ai çuni...

**Enver Memolla** . Me dhjetë, me shumicë nuk kalon.

**Mukades Gixhari** . Duhet 50 plus 1.

**Mitat Daja** . Pse nuk kalon?

**Enver Memolla** . Duhet njëmbëdhjetë. 50 plus 1 ke rregulloren.

**Indrit Dedej** . Nuk ka vendim që të kalojë poshtë njëmbëdhjetë votave.

**Mitat Daja** . Sa vota je në këshill ti? Sa është pjesëmarrja mos u tallni me njerëzit këtu se jeni dhe live. Ver mos u tallni. Sa vota jemi ?

**Mukades Gixhari** . Jemi 15.

**Mitat Daja** . 10 janë dakord që ky propozim të kalojë dhe thoni nuk miratohet. Kjo është gallatë.

**Silvana Aliu** . Nuk është gallatë se ti gjërat e tjera i kalon me 11.

**Mitat Daja** . Sekretari i këshillit mund të na japë zgjidhje për këtë punë, na sqaro këtë punë që ta dimë.



**Ervis Shera** . Është rasti që kalohet me shumicë të thjeshtë, kështu që miratohet.

**Mukades Gixhari** . Miratohet dhe me 10?

**Ervis Shera** . Shumicë e thjeshtë, shumica e të pranishmëve në sallë.

**Mukades Gixhari** . Miratohet.

*-Miratohet me 10 vota pro 5 vota kundër propozimi për zhvillimin e një dëgjese publike të dytë për Paketën Fiskale dhe Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024.*

**Mitat Daja** . Faleminderit shumë.

**Besnike Coraj** . Sa më shumë të dëgjohemi aq më mirë është.

**Fatmira Thartori** . Nuk është puna tek anëtarët e këshillit është për qytetarët ajo.

**Besnike Coraj** . Për punën e Bashkisë është akoma më mirë sa më shumë të dëgjojmë ankesat që njerëzit kanë, hallet do shkojë shumë më mirë dhe më ok.

**Mukades Gixhari** . Atëherë kalojmë në pikën 6, Raport nga administratorët e njësisë administrative Kryevidh, Lekaj, Sinaballaj. Fillojmë me administratorin e njësisë Kryevidh z. Shkelqim Gjoni. Z. Shkelqim përshëndetje!

**Shkelqim Gjoni** . Të nderuar këshilltarë përshëndetje! Periudha në të cilën ju kërkoni informacion përkon me sezonin turistik, ju që ta dini komuna Kryevidh është baza e turizmit për Bashkinë Rrogozhinë edhe sigurisht 60% e të ardhurave mbledhen në Njësinë Kryevidh. Kështu që edhe puna jonë kujdesi jonë i gjithë administratës Kryevidh është përkushtuar në drejtim të mirëmbajtjes së sezonit turistik. Mbase nuk keni shumë njohuri por unë ju them me sa përvojë që kam unë në atë drejtim atje në muajin Gusht aty frekuentojnë gati 25 mijë pushues në ditë.

**Mitat Daja** . Se ke shkruar këtu tek raporti sa veta e frekuentojnë.

**Shkelqim Gjoni** . E them me gojë.

**Mitat Daja** . Po pse nuk e shkruani dot këtu ju, shoh dhe ato raportet tjera që kanë sjellë ato administratorët tjerë që kanë çuar është për të ja çuar emergjencave civile më shumë se sa për ta dëgjuar në këtu.



**Shkelqim Gjoni** . Që në fillim ne e kemi filluar me sistemimin e punëtorëve sezonalë të cilët janë marrë me pastrimin e mbeturinave në rrugë. Në rrugë kryesore që të çon në bregdet me pastrimin e brezit të gjërë të pishave si dhe me pastrimin e plazhit publik sepse kjo është detyra jonë, është detyrë e njësisë të bëjë pastrimin e plazheve publikë të hapësirës së gjelbër se duhet ta dini që ne e kemi këtë ku hajmë aty i hedhim mbeturinat nuk e kemi akoma atë kulturë që të marrim një qese t’i çojmë tek kazani i mbeturinave. Ndërsa për dërgimin e mbeturinave, kanë punuar dy firma, firma e kontraktuar nga Bashkia dhe firma “Fusha” e kontraktuar nga qeveria. Një firmë e kryen pastrimin në mëngjes firma tjetër e kryen pastrimin në mbrëmje dhe nuk kemi pasur asnjëherë probleme dhe ankesa nga qytetarët dhe nga bizneset e zonës të paktën për këto vitet e fundit. Sepse kur koshat largohen mbeturinat në mëngjes e në mbrëmje dmth që largon dhe atë erën e keqe që mund të mbajë koshi i mbeturinave. Është për t’u festuar të paktën për njësinë Kryevidh që këtë vit që lam pas nuk patëm asnjë rast të mbytur, sigurisht që kjo është edhe shprersa nga Zoti por edhe një punë që kanë bërë rojet vrojtuese të plazheve. Sepse kanë fituar dhe ato me kalimin e viteve përvojën e nevojshme për të bërë ballë situatave emergjente. Siç jemi në dijeni në këtë periudhë kanë filluar edhe ndërtimi i rrugës Vilë Bashtovë - Guri i Lëmuar një rrugë kjo që i ka dhënë një hapësirë më të madhe biznesit por edhe i ka rritur vlerën pronave edhe banesave. Kështu që besoj që është një investim që do i ngrejë edhe më shumë të ardhurat e Bashkisë tonë për vitet në vazhdim.

**Mitat Daja** . Investim i Bashkisë apo i qeverisë?

**Shkelqim Gjoni** . Tani ky është një investim 3.5 milion euro nuk ka mundësi bashkia të investojë këtë shumë.

**Amarildo Duka** . Investim i qeverisë me kërkesë të bashkisë.

**Mitat Daja** . Pyeta dhe për publikun që ta dëgjojnë dhe ata.

**Shkelqim Gjoni** . Bashkia ka bërë kërkesën dhe projektin, gjithashtu një investim tjetër që mund të konsiderohet pjesë e investimit është edhe ndarja e kanalit kullues Kazie-bregdet gjithmonë në funksion të vijës bregdetare. Ndërsa ndër problematikat kryesore që ne kemi hasur në këtë periudhë janë mungesa trajtimit të ujërave të zeza. Nëse plazhi i Spillesë ka një pikë të dobët një pikë të errët, trajtimi i ujërave të zeza është pika më e dobët që ne na bën të ulim kokën. Sigurisht që ky është një investim i madh që kushton gati 12 milion euro dhe Bashkia nuk e bën për 100 mijë vjet këtë lloj investimi. Por kemi ndërhyrë bashkë me kryetarin e bashkisë meqenëse po bëhet dhe rruga e re është kërkuar një shtesë fondi që të trajtohet dhe të punohet dhe me kanalizimin e ujërave të zeza dhe të ndërtimit të trajtimit të impiantit të ujërave të zeza. Meqë po



bëhet investim i madh ky mbetet investim përgjysëm pa largimin e ujërave të zeza, se duhet me thënë atë që është një pjesë e ujërave të zeza derdhen në det. Problematikë tjetër që kemi hasur meqenëse na iku dhe drejtori i elektrikut është tensioni i ulët në zonën e bregdetit, aty banesat dhe pupullimi vijnë duke u shtuar, thashë që në muajin Gusht vijnë 20 mijë veta në ditë dhe normal që kërkohet një tension më i lartë. Shpresoj që të kryhet një investim për të ardhur një tension më i lartë në zonën e bregdetit.

**Mitat Daja** . Kjo është e domosdoshme, por çfarë hapash janë marrë për të bërë këtë punë?

**Shkelqim Gjoni** . Tjetër gjë që ne kemi hasur është dhe mungesa e eksavatorit me krah të gjatë për pastrimin e kanaleve kulluese që këto t'i paraprijmë mos presim që të vijë dimri dhe situata emergjente por t'i kryejmë në kohën e duhur. Po me sa jam në dijeni Këshilli Bashkiak ka miratuar blerjen e eksavatorit kështu që shpresojmë që do na ndihmoj në këtë etapë. Tjetër gjë që unë kisha në këtë periudhë është në Spille funksionon qendra shëndetësore verore por realisht aty nuk ka një autoambulancë që të rrijë gjatë gjithë ditës aty 24 orë tani këto funksionojnë me nr 127 por kur të vijë ambulanca nga Rrogozhina larg qoftë ai që mbytet është në emergjencë dhe nuk pret dot ka edhe trafik aty duhet një ambulancë. Ne si njësi kemi pasur 2-3 mjete në pronësi të komunës, tani aktualisht nuk kemi asnjë mjet autoveturë, të paktën për periudhën e plazhit sepse unë për periudhën e plazhit, punonjësi i shërbimeve dhe punonjësi i taksave, polici bashkiak por dhe unë jemi përditë në atë zonë nëse ka mundësi bashkia për një autoveturë të na e japë për ato tre muaj është e nevojshme.

**Mitat Daja** . Pse për tre muaj për gjithë kohën?!

**Shkelqim Gjoni** . Të paktën për ato tre muaj mos shpenzojmë shumë se do ngrehen dhe njësitë e tjera dhe do duan të gjithë.

**Mitat Daja** . Të gjitha të pajisen me mjete nëse është...

**Shkelqim Gjoni** . Po varet sa e ka mundësinë Bashkia, të gjithë duam gjëra por varet nga xhepi.

**Amarildo Duka** . Tani punonjësi i taksave është në varësi të bashkisë apo në varësi ...?

**Shkelqim Gjoni** . Është i joni e kemi pasur punëtor taksash.

**Amarildo Duka** . Nuk është i drejtorisë të ardhurave?

**Shkelqim Gjoni** . Është i njësisë.



**Indrit Dedej** . Në varësi të bashkisë.

**Shkelqim Gjoni** . Në varësi të bashkisë jemi të gjithë.

**Mitat Daja** . Çim janë disa kërkesa këtu që ke bërë nuk e di tani na përkasin në këto kërkesa psh ti ke thënë tensioni i ulët. Çfarë mund të bëjmë në Spilleja është zonë që duhet ti japim dorë se s'bën sepse ndihmon bashkinë. Por çfarë mund të bëjmë në për këtë sepse ky muhabet ka raportet që bëhen, disa raporte janë parë për t'u çuar tek emergjencat civile disa raporte nuk janë... Çfarë mund të bëjë këshilli bashkiak për tensionin e ulët që ti ke kërkuar këtu.

**Shkelqim Gjoni** . Thashë këto janë problematikat.

**Mitat Daja** . Problematikat por çfarë mund të bëjmë ne, si mund të të ndihmojmë ne ty?

**Shkelqim Gjoni** . Me anë të drejtorit që ka Rrogozhina t'i bëjmë një kërkesë Tiranës apo Durrësit.

**Mitat Daja** . E bën Këshilli Bashkiak Andi?

**Andi Proshka** . Këto janë problematika. edhe me kanalet këto janë problematika që ju të jeni në dijeni të ngrini zërin më lart se duhet.

**Mitat Daja** . Po mirë a do bëjmë ndonjë relacion nga këshilli bashkiak për këto probleme?

**Fatmira Thartori** . A mund të bëhen projekte dhe këto projekte shkojnë diku dhe mund të bëhen pastaj në zonë sidomos në zonën bregdetare gjatë verës si në Gosë, si në zonën e Vilës Kryevdidhit të gjithë zonën bregdetare mund të bëhen këto, mund të bëhet projekt?

**Andi Proshka** . Prandaj ishte thirrur dhe përgjegjësi i OSHE-së për t'u njohur me këtë problematikë.

**Fatmira Thartori** . Përgjegjësi iku por a mund të bëhet ndonjë projekt për këto?

**Amarildo Duka** . Projekte bën OSHE nuk bëjmë ne.

**Fatmira Thartori** . Po mirë të ishte çuni këtu se ne prandaj jemi këtu.

**Mukades Gixhari** . Z. Enver Memolla.



**Enver Memolla** . Sa i përket përgjegjësve të OSHE-së ishin të tre prezentë te unë Indriti dhe kryetarja është një defekt në zonë në Lekaj që u larguan direkt për këtë punë. Tani gjëja tjetër këto janë të drejtorisë rajonale nuk i përkasin Bashkisë Rrogozhinë, varen nga drejtoria rajonale e Durrësit dhe këtu e kemi thirrur dhe herë tjetër para... dhe ka thënë që ne këtu mbajmë përgjegjësi për sa i përket shërbimit të klientit për qytetarin, pjesën e investimeve e kemi bërë kërkesën lart për 20 - in që do si Vila në Gosë dhe Lekaj por dhe zona e Kryevidhit që një pjesë e mer nga Divjaka këto janë investime që vijnë nga qeveria qendrore nuk janë që i bën këshilli bashkiak. Këshilli Bashkiak mund të thërrasi në raport drejtorin e drejtorisë rajonale të OSHE-së Durrës mund ta thërrasi po kemi të drejtë ligjore t'i çojmë shkresë zyrtare të vijë në mbledhjen e radhës të raportojë ne këtë e kemi në dorë...

**Mitat Daja** . Këtë po them...

**Enver Memolla** . Për pjesën e investimeve ...

**Fatmira Thartori** . Kërkesa ne jemi zëri i qytetarëve dhe ne duhet të ja drejtojmë dikujt, kështu që ne këtë po kërkojmë bëht një projekt nga kush bëhet, të bëhet nga Bashkia apo bëhet nga OSHE-ja? Dhe ne bëjmë zgjidhjen t'i japim drejtim situatës.

**Hekuran Xhani** . Tek informacioni je shprehur për nevojën e një ambulance e cila lidhet drejtpërdrejt me shpëtimin e jetës së njeriut. Si mendon ti, si mund ta zgjidhim?

**Shkelqim Gjoni** . Kjo në bashkëpunim me drejtorinë e ...

**Fatmira Thartori** . Ose ministrinë e shëndetësisë ndoshta.

**Hekuran Xhani** . Në lidhje me eksavatorin deri ku është arritur sepse ne e kaluam me vendim.

**Andi Proshka** . Ka nisur si procedurë për blerje.

**Hekuran Xhani** . Në bashkëpunim me administratën ndihmëse të marri zgjidhje emergjente ambulanca dhe eskavatori të mos vonohet...

**Shkelqim Gjoni** . T'i bëjmë punët në kohë mos presim emergjencat.

**Erind Tosku** . Unë kisha faktikisht një pyetje për sa i përket, ndonjë problematikë që kanë më emergjente hotelet, restorantet në zonën e Spillesë mund të na jepni mund të na jepni çfarë



problematike kanë që dhe tek projektbuxheti që do na vijë i shqyrtuar i punuar a mund të na thuash që çfarë problematike kanë? Se ne do rrisim dhe taksat e pastrimit e mirëmbajtjes etj? Çfarë problematike ka që ne të ja përmirësojmë këtë që dhe biznesi të dijë u rrit taksa por shërbimi...

**Shkelqim Gjoni** . Të thashë që problemi kryesor është trajtimi i ujërave të zeza është pika më e rëndë e plazhit të Spillesë, se plazhi e ka pishën e ka rërën ka pastrimin që bëjmë ne por ujërat e zeza janë pikë e errët që ul kokën nuk ke çfarë të thuash.

**Amarildo Duka** . Është investim gati 11 milion euro.

**Erind Tosku** . Vetëm ujërat e zeza kanë problem?

**Shkelqim Gjoni** . Këtu është pika më e errët tjerat përballohen.

**Fatmira Thartori** . Edhe energjia e dobët elektrike.

**Shkelqim Gjoni** . E thashë.

**Fatmira Thartori** . Po pra këto janë më emergjentet që duhen patjetër.

**Erind Tosku** . Bashkia ka projekt për menaxhimin e ujërave të zeza, për rivitalizimin mirëmbajtjen ose rirregullimin e këtyre gjërave.

**Geraldo Gjini** . Bashkia me stafin që ka nuk bën dot projekte të atij niveli sepse siç po thonim është projekt që shkon me miliona euro por ujësjellës kanalizime Durrës ka nisur procedurën në dijeninë time po bën një studim paraprak çfarë tubacioni duhet, me çfarë impianti edhe trajtimi i ujërave të ndotu menaxhohet nga ujësjellësi.

**Erind Tosku** . E kisha më shumë në qoftë se Bashkia jonë nuk ka potencial për projekte të këtyre përmasave dhe nuk i ka në dosjet e bashkisë mund të ketë një fond ose të nënkontrakttojë një zyrë që të merret me këto lloj projektesh?

**Amarildo Duka** . “Arabel “ e ka studio, në dijeninë time është projekti.

**Erind Tosku** . Dmth është projekti? Çështja është thjeshtë presim miratimin ... Edhe diçka kemi marrë vesh nga rrjetet sociale që në qendrën shëndetësore Rrogozhinë është shtuar një tjetër





autoambulancë dhe është një gjë shumë e mirë. Besoj që me drejtorinë e shëndetit që kemi ne mund të bëhet diçka që tre muajt e verës një nga autoambulancat të shkojë në Spille? Besoj që ju të merreni me këto lloj procedurash që të bisedoni...

**Andi Proshka** . Ne e kemi pasur një takim me drejtorin e spitalit dhe na ka thënë ok. Një ambulancë i ka të gjitha mjetet e duhura...

**Enver Memolla** . Do e japë drejtori i qendrës shëndetësore apo i ISHP-së Kavajë?

**Andi Proshka** . Ajo autoambulancë i është dhuruar qendrës shëndetësore spitalit në Bashkinë Rrogozhinë.

**Enver Memolla** . Po flet për këtë të renë që ka ardhur tani?

**Andi Proshka** . Po me një marrëveshje gjatë sezonit veror i ka të gjitha mjete e duhura .

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje tjetër për z. Shkëlqim? z. Shkëlqim faleminderit për gjithçka. Administratori i Sinaballaj për arsye personale nuk është sot në mbledhje.

**Mitat Daja** . Kush është ai zysha që nuk është ?

**Mukades Gixhari** . Tani kalojmë tek administratorja e Gosës znj. Valmira Troka.

**Mitat Daja** . Zysha kam një kërkesë përpara se të fillojë Valmira se e kam pasur dhe kolege dhe e ka shkruar raportin më mirë nga të gjithë. Po meqë është Andi nënkryetari i Bashkisë dhe Sekretari i Përgjithshëm kam një emergjencë të madhe për zonën e malësisë sepse tani është koha e prodhimit të ullinjve dhe tani gjithë ajo zonë atje është për turp që të paktën nuk çohet buldozeri apo çfarë mjetesh ka Bashkia për të pastruar pak rrugën është zonë komplet malësia është emergjencë është kërkesë...

**Mukades Gixhari** . Tek të ndryshme z. Mitat, ke shumë të drejtë.

**Mitat Daja** . Meqë ai nuk është sepse do ja kërkoja atij meqë nuk do diskutohet tani, thashë për sot ta diskutojmë sot jo për herën tjetër.

**Valmira Troka** . Atëherë problemet më të shumta në zonën e njësisë administrative Gosë i kemi në fushën e bujqësisë na duhet patjetër pastrimi i kanaleve vaditëse dhe atyre kulluese.



Pavarësisht se ne me punonjësit e shërbimeve pak a shumë e kemi bërë një mirëmbajtje të kanaleve por kjo nuk është se ka qenë e mjaftueshme. Është bërë një punë nga bordi i kullimit me kanalin kullues K5, i cili është në përfundim kemi pastruar pak a shumë disa kanale në Gosë të Madhe, në Gosë të Vogël, Kalush dhe Kërçukaj edhe pse ne kemi bërë disa pastrime paraprake kjo nuk ka qenë e mjaftueshme sepse ngelet një punë shumë e madhe për t'u bërë. Kemi plot 20 kanale kulluese të dyta në kënetën e Gosës qendër për t'u pastruar, gjithashtu e domosdoshme është për t'u pastruar kanali kullues i ujërave të larta Lekaj që bëhet në derdhjen e Shkumbinit dhe kjo sjell pasojë përmbytjen e tokave që kap komplet zonën e Gosës. Gjithashtu jemi marrë si njësi me pastrimin e ambienteve publike, shkollave, rrugëve. Ne si njësi kaq mundësi kemi pastaj...

**Mitat Daja** . Tani për këtë tek taksat ose tarifatat që keni mbledhur ju aty, ti ke shkruar vetem fakt por sa ka qenë plani nuk e ke shkruar, ne nuk e dimë se sa ka qenë menduar të realizohet e para. E dyta ke një taksë tregu për 6-mujorin është ky apo jo?

**Valmira Troka** . Nga Qershori deri në Tetor e ke.

**Mitat Daja** . 46 mijë e 500 e ke taksë tregu, sa i bien me të vjetra apo me të reja?

**Valmira Troka** . Me të vjetra.

**Mitat Daja** . Tregun e administrojnë njësia administrative apo jo?

**Valmitra Troka** . Po.

**Mitat Daja** . Sa është tarifa aty për një tavolinë.

**Valmira Troka** . Nuk është se ne kemi marrë një tarifë konkrete...

**Mitat Daja** . Si nuk keni marrë? Shkon dhe merr sa i tekjet atij...

**Valmira Troka** . Zakonisht kemi marrë... nuk është zyrtare.

**Erind Tosku** . Mesa di unë tarifë fikse ka tregu i Rrogozhinës...

**Mitat Daja** . Po ka për m<sup>2</sup> është përcaktuar...



**Erind Tosku** . Dhe në Rrogozhinë ke pjesën e trotuareve aty që...

**Mitat Daja** . Më vjen keq tani në rrugë ka një tarifë për sa m<sup>2</sup> ka vendosur tezgë ai personi?

**Orges Tosku** . Është 500 lekë të vjetra për m<sup>2</sup>.

**Mitat Daja** . Po të pjesëtojnë këtë, tregu bëhet një herë në javë, i bie 4 herë në muaj I bie që mund të ketë 20-30 tregtarë kaq ka tregu?

**Valmira Troka** . Pak a shumë aq, tani që të jemi konkret një fshatari të thjeshtë që shet dy specat, dy qepë...

**Mitat Daja** . Kam frikë se nuk është pa lekë ai fshatari i shkretë, ai fshatari shkretë e paguan tarifën.

**Valmira Troka** . Mund t'i marrim 100 lekë të vjetra.

**Mitat Daja** . Nuk ka ndodhur nuk ndodh kjo.

**Valmira Troka** . Ndodh.

**Mitat Daja** . Ta siguroj unë që nuk ndodh. Ai fshatari shkretë paguan një mijë lekëshin se po nuk pagoi... por shikojeni pak këtë shikojeni pak tregun. Unë ju këshilloj që ta shikoni tregun.

**Valmira Troka** . E shohim tregun ne por problemi është se nuk është se ka dhe aq shumë njerëz që ata tregtarët të bëjnë punë, çfarë të bëjnë t'i marrim frymën?

**Mitat Daja** . Jo.

**Orges Tosku** . Tregtarë të mirëfilltë ke shumë pak.

**Mitat Daja** . Sa tregtarë ka në tregun e Gosës a ka ndonjë bllok aty që paguhet tarifa?

**Valmira Troka** . Patjetër që ka bllok.

**Mitat Daja** . Sa veta paguajnë në javë aty në treg të Gosës? Po të bëj një pyetje meqë ndërhyre si drejtor taksash.



**Orges Tosku** . 70-80 mijë lekë të vjetra në javë.

**Mitat Daja** . Na dëgjojnë dhe njerëzit, unë propozoj tani 3- vetë një komision nga këshilli të shkojnë dhe të mbledhin taksat një javë atje edhe ta shohim.

**Orges Tosku** . Po ta them pra shumica janë tregtarë të zonës.

**Erind Tosku** . Bashkohem pak me Mitatin tek pjesa, a është kërkuar nga Njësia zhvendosja e tregut mos me e lënë aty në mes të rrugës dhe me i gjetur një hapësirë që të mbledhë taksat më mirë. Unë mendoj se aty një pjesë...

**Valmira Troka** . Atë gjë unë e kam menduar dhe me të drejtë kam pasur edhe fondacion për ta bërë një treg të mirëfilltë por nuk kam pasur zonë nuk kam pasur tokë shtet, vend hapësirë publike që të bëj tregun, se edhe investimi më është ofruar por nuk kam gjetur...

**Fatmira Thartori** . Sa për tregun ne që jemi banorë të Gosës, ai treg aty duhet ndryshuar sepse në mëngjes ne të gjithë kalojmë aty herët përveçse është e zënë komplet xhadeja, pra nga të dyja anët është dhe rrezik për kalimin e fëmijëve aty se do kalojnë në xhade ato nuk ke nga kalon tjetër. Nga një anë tezgat që shesin dhe nga ana tjetër pastaj i bie mes përmes xhades dhe mendimi jonë... Si mendon ti Tasha? Jo vetëm thjeshtë orari gjejmë hapësirë por mund të jetë edhe brenda për brenda qendrës së Gosës siç ka pas qenë më përpara që nuk rrezikonte asnjë edhe u mblidhnin më mirë taksat. Kurse aty në xhade është diçka që duhet patjetër emergjente të ndryshohet.

**Mitat Daja** . Tani tregun nuk mund ta largosh shumë.

**Valmira Troka** . Jo jo brenda për brenda Gosës siç ka qenë.

**Besnike Coraj** . Dhe unë për këtë doja të flisja si tha dhe Vali të gjenim një hapësirë tjetër.

**Fatmira Thartori** . Tek pallatet siç ka qenë më mirë aty.

**Mitat Daja** . Duhet të kuptoni diçka që tregu sa më afër rrugës aq më shumë është eficient kush ka bërë tregti e kupton këtë gjë, tek shkolla nuk është eficient.

**Besnike Coraj** . Nuk po flasim që të jetë tek shkolla.



**Valmira Troka** . Ambulanca të ketë kushte të ketë personelin të kualifikuar...

**Besnike Coraj** . Unë kam qenë vetë por nuk jepej ndihma e kërkuar ishin tre mbytje ... ambulanca do shumë kushte, i kanë kapur njerëzit me peshqirë ka qenë një pamje nuk e di ç'të them. Kemi qenë aty gjithë si staf por nuk bënim dot asgjë po nuk ishte shërbimi me ambulancë me kushte me... kjo është edhe për ne nuk është vetëm për...

**Mukades Gixhari** . Është e drejtë znj. Besnike. Z. Indrit.

**Indrit Dedej** . Sa për tregun meqë rruga nacionale nuk kalon nënë them është më i përshtatshëm aty edhe për bizneset sepse është edhe hapësira më e madhe kurse brenda në komunë ku është ajo lulishtja e vogël nuk mblidhet nuk ka shans.

**Valmira Troka** . Duke e çuar në rrugë kam menduar që të ushqehen edhe bizneset një herë në javë të paktën.

**Fatmira Thartori** . Jam dakord tek ajo pjesë që është rrugë nacionale nuk paguan taksa dhe taksat i mblidhni ju por puna është a nuk rrezikohen qytetarët pak më parë u tha aty që nuk ka shumë tregtarë, kurse tani ka tregtarë... dhe nuk ka shumë tregtarë dhe këto pak tregtarë mund të shkojnë prap në ato zona ku ka qenë tregu që prap komuna i merr taksat njësia administrative i merr taksat nuk i merr biznesi. Prap brenda për brenda rrethit të qendrës së Gosës që janë nëpër palate kurse aty është rrezik dhe të gjithë më kanë thënë që unë ta ngre zërin për këtë pjesën që të gjithë kur kalojmë në mëngjes është tmerr dita e Mërkurë sepse nuk kalohet as me makina por edhe fëmijët ke frikë do i përcjellësh fëmijët prindërit vijnë kastile për të përcjellur fëmijët, ditët tjera jo por atë ditë i përcjellin dhe i marrin sepse është ngarkesë është në rrugë nacionale.

**Valmira Troka** . Unë them të kalojë tek një pjesë e dytë dmth të kalojë tek pjesa ku është që ka qenë lokali i Takut, që del përmes lagjeve një ditë për dy orë ose tre orë bëhet dërman dmth të besh thjeshtë lëvizjen t'i tjetërsosh. Është një rrugë alternative dmth edhe mund të bëhet.

**Indrit Dedej** . Merr policinë bashkiake atë ditë që ka treg të vijë aty.

**Erind Tosku** . Vali kishim një propozim dhe një sugjerim që tek problematikat që i kategorizoni primare sekondare etj. Të shihet që ajo rruga Gosë-Vilë Bashtovë që janë ato ferrat kallamishtet të pastrohet dhe të dali kanali në pah se nuk e dimë ku është fundi rrugës, sa i thellë është kanali dhe të paktën të prehet. Është prerë vetëm njëherë këtë sezonin e verës e kam parë vetë personalisht ...



**Valmira Troka** . Po e kam çuar unë.

**Erind Tosku** . Por nuk prehet ashtu, duhet prerë taman të dali trafikndarësja, ka qytetarë ngaqë i kanë zënë kallamishtet nuk e dinë që ka trafikndarëse.

**Valmira Troka** . Ka qenë privatisht.

**Enver Memolla** . Edhe për të mos e zgjatur shumë unë dy gjëra kam, meqenëse kemi dhe Valin këtu që të marrim në shqyrtim kërkesën e zotërisë që është nga Gosa edhe e dyta përpara kësaj marr shkas nga fati keq i kolegut tonë Bajazitit atë ditë që isha atje erdha prap vura re që ajo rrugë Vilë Bashtovë Gosë është pa sinjalistikë. Dhe do kërkoja nuk e di se sa mundësi ka Bashkia me ARRSH-në për këtë pjesë sidomos si tek ura e Çopanit, si dhe kthesa e fortë aty të paktën disa mburoja anësore sepse i bashkohem asaj që tha Erindi ne nuk e dinim që ishte aq i gjërë ai kanal, tani e pamë që u pastrua K5 se dhe rruga aty ka disnivelet e veta, realisht ajo kthehet në rrugë sezonale për plazhin sidomos edhe për të ikur në Spille më shkurt por edhe për të shkuar në Vilë Bashtovë që po ngrehet tani së fundmi. Realisht kjo është një kërkesë që nuk do lënë pas dore Val, sepse ndodhi një tragjedi të mos kemi të dytë më. Për pjesën e barrierave këtë e kam thirrje për gjithë Bashkinë jo vetëm për ... se realisht aty është minë me sahat, rruga nuk ka nivel për arsye të tokës që ujë këtej ujë andej dhe zbutet dhe tonazhi bën punën e vet por ajo është minë me sahat. Makina është ne qytetarët e thjeshtë jemi me këmbët e huaja jo me këmbët tona rrëzohemi kollaj por mos ndodhë fatkeqësi tjetër, se e kam ballë për ballë të ndjerin realisht që atë ditë që e pamë...

**Indrit Dedej** . Është përgjegjësi e zyrës...

**Enver Memolla** . Është përgjegjësi kjo pjesë. Andi nuk e di nëse e mbajte shënim këtë pjesën e Vilë Bashtovës. Tani edhe kjo pjesa tjetër për kërkesën meqë është edhe Vali që të mos e shkëpusim, ta diskutojmë këtë pjesën e kërkesës.

**Mukades Gixhari** . Atëherë kemi një kërkesë nga Njësia Administrative Gosë.

Kryetarit të Bashkisë z. Edison Memolla.

Kryetares së Këshillit znj. Mukades Gixhari.

Unë i quajturi Darda Zejnel Vallasi banor i fshatit Gosë qendër, ju patashtroj kërkesën time si më poshtë vijon :

Kam një shtëpi të ndërtuar para 20 vitesh me Çertifikatë Pronësie të banesës dhe të tokës truall mbi të cilën është ndërtuar shtëpia. Firma që ndërtoi para disa vitësh shkollën e re kur bëmë



rrethimin e shkollës muri rrethues nga ana e shtëpisë time është vendosur pothuajse ngjitur me shtëpinë time. Kjo më heq mundësinë të bëj qoftë edhe një shërbim të vetëm për nevojat që i duhen shtëpisë, e pakta për një pastrim të thjeshtë por edhe për t'i ardhur rreth shtëpisë për nevoja në të ardhmen.

Ju lutem Bashkisë Këshillit Bashkiak që të më mundësohet që nga ana ku kam këtë problem të më ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi nga sa ju parashtrova më sipër jam i gatshëm që shpenzimet t'i heq vetë deri në përfundim të punimeve.

Faleminderit duke shpresuar që kërkesa ime të merret parasysh.

Me respekt, Dardan Zejnel Vallasi

Është dhe certifikata e pronësisë.

**Besnike Coraj** . Kjo qëndron problemi që ka zotëria është e vërtetë në hapësirën që ai ndahet nga shkolla ai nuk futet nuk ka fare hapësira që t'i vijë shtëpisë së tij rreth e rrotull.

**Valmira Troka** . Madje ishte tani nuk ka as tre javë që ai donte të bënte një ndërhyrje tek shtëpia e tij dontë të suvatonte dhe na ka marrë leje ne për të vënë skelat nga ana e shkollës sepse është avllia muri rrethues i shkollës ...

**Besnike Coraj** . Ai do të shtyjë pak murin e shkollës që të ketë hapësirë të kalojë ...

**Erind Tosku** . Tani shkolla i ka zënë hapësirën zotërisë apo avllia është hapësirë e shkollës?

**Valmira Troka** . Është e shkollës.

**Besnike Coraj** . Ai ka shumë vite që e ka bërë shtëpinë aty është truall i vjetër.

**Altin Tosku** . Ai duhet t'i lejë vetë hapësirë vetes së vet për më bërë shtëpinë nuk do futesh ti në hapësirën e shkollës.

**Mukades Gixhari** . Informacion, komshiu që është afër zotërisë avllia që i ka qëlluar tek shtëpia ka marrë ato hapësirat sepse zotëria ka bërë dhe foto, tek komshiu që është si zotëria i ka ardhur avllia me zig-zag dmth i është krijuar mundësia komshiut që të ketë hapësirë mbrapa shtëpisë, ndërsa zotërisë në fjalë ju ka ngjitur fiks fare. Të dëgjojmë pak z. Enver.

**Enver Memolla** . Tani kjo është një problematikë që jo vetëm zotërisë që e ka sjellë por dhe persona tjerë që njoh unë që kanë të tilla përplasje në bashki apo komuna. Unë kam disa pyetje



faktikisht por po e nis nga e para: Kur filluan punimet e shkollës së re që u bë nga rindërtimi, zotëria e ka pasur hapësirën nga pas që kërkon?

**Altin Tosku** . E ka pasur truall...

**Valmira Troka** . Punimet kur janë bërë janë bërë po tek themeli i vjetër edhe avllia e shkollës...

**Enver Memolla** . Po flas për rrethimin.

**Valmira Troka** . Po pra rrethimi i avllisë është bërë po tek e vjetra nuk është lëvizur.

**Enver Memolla** . I bie që është në kufi të vet rrethimi i shkollës.

**Valmira Troka** . Po.

**Enver Memolla** . Atëherë zotëria kërkon hapësirë nga shkolla tani? Dhe i bie që të japim hapësirë publike, jo se e ka zënë shkolla?

**Valmira Troka** . Jo nuk e ka zënë shkolla.

**Enver Memolla** . Këtu lind ngërçi sepse zotëria duhet të dijë shumë mirë që ka një hapësirë ligjore që në bazë të kufirit ka  $1 \text{ m}^2$ , linear që duhet të rrijë larg kufirit apo jo? Gerald kam një pyetje, çdo objekt a e ka hapësirën e kuadratëve që duhet të ketë brenda llojit të vet? Sepse këtu ndodh ajo nuk i ka hyrë shkolla në territory.

**Valmira Troka** . Po.

**Enver Memolla** . Pikërisht pra që ta kemi të qartë këë pjesë. Në rregull unë po them që në qoftë se shkolla nuk i ka prekur hapësirën publike, hapësirën personale të z. Dardan dhe nëse muri kufitar është po i shkollës nuk e kemi ne si shqyrtim por ama nëse ai pretendon nga ana e komshiut kjo është pjesë që e zgjidh vetë urbanistika me anë të hartës që ka vetë ne kadastër nuk është pjesë e këshillit.

**Erind Tosku** . Kjo kthehet në precedent pastaj ka shumë banesa që janë afër shkollave, afër spitalit, thotë ai shiko se spitali më shqetëson...

**Valmira Troka** . Nëse një metër nuk i prish punë shkollës...





**Andi Proshka** . Personi nuk është se po ankohet ai po kërkon bashkëpunim. Edhe ato komshinjtë që ka aty i kanë ruajtur distancat vetë.

**Enver Memolla** . Unë propozoj që kërkesa e zotërisë t'i shkojë zyrës kompetente, të merret me problemin ne nuk kemi vendim këtu.

**Indrit Dedej** . Unë kam një mendim ndryshe me komisionin e konflikteve bashkë me zyrën e Urbanistikës dhe shohim atje...

**Geraldo Gjini** . Ajo pjesë është e qartë edhe ai nuk pretendon që i ka zënë shkolla.

**Hekuran Xhani** . Ky është një problem që i përket Njësisë Administrative, ky është një problem që e dinë mirë administratorja dhe këto zonjat që përfaqësonjë njësinë në këshill. Unë mendoj t'i japim një zgjidhje atij qytetarit që ne jemi këtu në emër të tyre dhe të mos i vijmë për qark ligji apo Maliqi se kështu as për 10 vjet nuk mbarojmë punë...

**Valmira Troka** . Unë jam dakord që atij t'i lejohet që në një krah të shtëpisë t'i lirohet 1 m. Ne nuk na prish asnjë lloj pune.

**Hekuran Xhani** . Këshilli është dakord edhe të votojmë për të ja zgjidhur problemin atij.

**Andi Proshka** . Ngrihet një grup verifikimi që të ngrihet ta verifikojë.

**Enver Memolla** . Indrit sot e ke kërkesë nuk merr dot vendim sot.

**Indrit Dedej** . Ne kemi të drejtë verifikimi.

**Fatmira Thartori** . Nuk kemi të drejtë ne të ngrejmë komision se është bashkia institucion.

**Hekuarn Xhani** . Si anëtar i këshillit bashkiak ke të drejtë tit ë shqyrtosh ankesat dhe kërkesat e qytetarëve?

**Enver Memolla** . Për shqyrtim jam por jo për vendim.

**Hekuran Xhani** . Por dhe do i japësh zgjidhje zotëri, se këshilli është organ vendimarrës. Indrit këshilli ka përfaqësuesin e vet atje kanë shkuar e kanë parë mirë, është drejtuesja e njësisë është ajo zonja nga Gosa do dhe ti nga Rrogozhina me e parë shko shihe. Ti japim zgjidhje problemit jemi për të zgjidhur hallin ...



**Mitat Daja** . Atëherë Vis, ti je nga ana ligjore ne mund të marrim dot një vendim për ta zgjidhur këtë problem.

**Ervis Shera** . Përgjigjen ta jep drejtori i Urbanistikës.

**Mitat Daja** . Drejtori i urbanistikës ne mund të marrim një vendim për këtë?

**Geraldo Gjini** . Kjo nuk është tagër as e juaja as e jona sepse ajp është ambient i shkollës ajo që të hiqet një pjesë toke e shkollës duhet të kalojë me VKM nuk e kaloni dot as ju as ne.

**Mitat Daja** . Tani çfarë mund të bëjmë ne? Këtë po them pse zgjatemi shumë a bëjmë dot gjë ne?

**Hekuran Xhani** . Banesa e këtij e ka hapësirën e nevojshme sipas ligjit? Qenka më e rëndësishme Ministria e Arsimit se banorët e bashkisë Rrogozhinë. A mund t'i shërbejmë ta ndihmojmë qytetarin se drejtuesja e njësisë thotë që e ndihmojë qytetarin pa i bërë dëm shkollës. Pse mos e ndihmojmë ne?

**Indrit Dedej** . Qytetari mund ta ketë bërë ndërtesën me distancën nga muri i shkollës mbrapa ka bërë një kacolle. Tani nuk është faji jonë se ka shtuar kacolle atje, ne shohim ka tokë ska tokë.

**Alime Hoxha** . Ne nuk kemi të drejtë të ja japim atë çfarë diskutojmë.

**Erind Tosku** . Drejtori urbanistikës na dha përgjigjen zyrtare ligjore tha pa vendim nga këshilli i ministrave për hapësirën publike që zotëron shkolla se shkollat kanë çuar hartën atje. Shkollat kanë çuar hartën sa hapësirë kanë shkollat dhe është miratuar në Ministrinë e Arsimit, gjimnazin tonë ja kam çuar unë hartën atje dhe nuk preket. Tani hajde të gjejmë një zgjidhje nuk kemi çfarë t'i bëjmë nuk është në tagrin tonë kjo pjesë.

**Enver Memolla** . Në bazë të kërkesës që ka bërë Bashkia Rrogozhinë të ngrëjë komision të verifikojë faktin në terren të zotërisë dhe të marri vendim Bashkia vetë pastaj.

**Hekuran Xhani** . Kjo zonja po thotë që ka mundësi të ndihmoht qytetari, këto zonjat përfaqësuese të njësisë administrative Gosë thonë që ka mundësi të ndihmohet mos i kërkon frymën ligjit. Ai thotë ka mundësi ta ndihmojmë hajde ta ndihmojmë ne jemi këtu për të ndihmuar.



**Enver Memolla** . Të mos keqkuptohemi drejtori i kadastrës thotë nuk ka mundësi ligjore nëse është pronësi shtet duhet VKM ...

**Mukades Gixhari** . Atëherë Bashkia do ngrejë verifikimi për ta ndjekur kërkesën e zotërisë.

**Hekuran Xhani** . Këshilli është dakord me zgjidhjen e problemit të qytetarit.

**Mukades Gixhari** . Kemi administratorin e njësisë administrative Lekaj z. Altin Mema.

**Altin Mema** . Meqenëse profesori na bëri pak vërejtje për relacionin them më mirë të shprehi ato pakënaqësitë që ka, çfarë pyetje ka t'i përgjigjemi. Të mirat nuk ja them se ja kam shkruar ai do të këqiat që nuk i kam shkruar prandaj po pres...

**Mitat Daja** . Po mirë pse mbaheni tek profesori ju...?

**Altin Mema** . Sepse ti e bëre vërejtjen.

**Indrit Dedej** . Performanca jote është e shkëlqyer, i ke dhënë ndonjë ndihmë fshatarëve tonë atje sipër?

**Altin Mema** . Me naftën unë jam më i miri nga njësitë administrative janë 365 persona që kanë marrë.

**Fatmira Thartori** . E ka për fushatën e ullinjve.

**Altin Mema** . Ullinjët nuk kanë mbajtur.

**Enver Memolla** . Altin diga e rezervuarit është funksionale?

**Altin Mema** . Diga është bërë dy vjet ka që është bërë.

**Enver Memolla** . Porta?

**Altin Mema** . Porta ka rrjedhje akoma por është normale nuk ndonjë rrjedhje të madhe që të bëhet shqetësim i madh. Po të bëhet rrjedhja është investim 5 mijë euro.

**Mitat Daja** . Është investim i madh 5 mijë euro?



**Fatmira Thartori** . Është investim i madh 5 mijë euro? Po vetëm ne të zonës atje e bëjmë atë.

**Mitat Daja** . Ka pasur një problematikë të madhe për vaditjen në Gërmej. Tani është bërë ndonjë përçapje për ta rregulluar këtë problem?

**Altin Mema** . Ky është investim goxha i madh duhen diku tek 500 milion lekë të vjetra unë e kam shënuar aty është pjesa e “Lugut” është dhe pjesa e “Fogut” me emërtimin popullor siç njihet.

**Mitat Daja** . Unë kam dëgjuar për një tub normale që mund ta blejë.

**Altin Mema** . Nuk janë tuba normale ato.

**Mitat Daja** . Është bërë një projekt për ta rregulluar këtë? Është gjithë ajo zonë.

**Altin Mema** . Është bërë dhe i ka shkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe ka 2 vjet.

**Mitat Daja** . Përgjigja për këtë?

**Altin Mema** . Nuk ka ardhur se i vjen Bashkisë nuk i vjen njësisë edhe ministrisë Bashkia i drejtohet.

**Mitat Daja** . Bashkia si mund të lehtësojë këtë punë?

**Altin Mema** . Bashkia vetëm të këmbënguli t’i shkruaj shkresa gjithmonë.

**Mitat Daja** . Pra edhe këtë vit nuk shpresohet që të ketë diçka...

**Altin Mema** . Nuk e them dot, ndoshta bëhet për dy muaj ajo kryhet.

**Fatmira Thartori** . Mitat na lër ne që jemi banorë të zonës të flasim e të kërkojmë.

**Mitat Daja** . Fatmira ti ke konflikt interesi.

**Fatmira Thartori** . Absolutisht burrin nga Okshtuni vetë nga Gosa. Atëherë për sa i përket portës ky projekti që është planifikuar a e përfshin portën apo jo? A e përfshin atë tubin që tha ai çuni?



**Altin Mema** . Saimir porta është bërë në kohën që ka qenë Bushi. Kurse tek diga është porta është bërë në kohën që ka qenë Bushi është hedhur ajo baza materiale është ngjeshur janë hedhur gurët është bërë kanali me veshje betoni.

**Fatmira Thartori** . Si mund t’i japim një zgjidhje ne si banorë të asaj zone të gjithë ose edhe Bashkia?

**Altin Mema** . Aty porta do një investim të dytë.

**Fatmira Thartori** . Atëherë ne po e bëjmë këtu publike na duhet një portë për atë zonën atje.

**Saimir Cani** . Porta është por thjeshtë duhet rregulluar pjesa poshtë që të mos dalë uji.

**Altin Mema** . Nuk ta merr njeri përsipër Saimir me e bërë, këtu e kemi problemin se është 17 m portë.

**Fatmira Thartori** . Të bëhet përpara verës është puna që të grumbullohet uji dhe pastaj të bëhet vaditja gjatë periudhës së verës.

**Indrit Dedej** . Kush e administron rezervuarin?

**Altin Mema** . Bashkia.

**Indrit Dedej** . Po rritjen e peshkut kush e administron?

**Altin Mema** . Asnjë. Ai rezervuar është kërkuar nga dikush dhe nuk është dhënë.

**Hekuran Xhani** . Altin për rrugën Okshtun Levanaj disa qytetarë kanë ankesa sepse ngritja e ujit nuk i lejon që të kalojnë me mjete atje, si mund të zgjidhet për t’i dhënë mundësi sepse atje janë gjithë ato toka gjithë ato prona.

**Altin Mema** . Urbanistika pati duhet një investim i madh përderisa kjo nuk u krye në kohën e atij qoftëlargut që iku.

**Hekuran Xhani** . Në atë kohë unë kam qenë këshilltar, në atë kohë funksiononte rruga.

**Altin Mema** . Vetëm për verë kur mbushet me ujë nuk kalohet se tani kalohet se nuk ka ujë rezervuari.



**Hekuran Xhani** . Është shumë e lehtë është vetëm një luginë që do mbushur me shkuar mjetet po për 5 mijë euro,

**Altin Mema** . Problemi ndodh kur mbushet rezervuari me ujë se tani aty kalohet po kur mbushet... edhe ai investimi që thanë ata prap do kalojë uji sipër është e pamundur. Është një rrugë nga lart por don shumë investim.

**Fatmira Thartori** . Rruga nga lart do thjeshtë skrepin se unë kam kaluar tek ajo rruga me skrep nuk do kishte shumë harxhim.

**Altin Mema** . E di sa do ajo? -Dy muaj punë me skrep.

**Fatmira Thartori** . Është i Bashkisë skrepi të punojë atje dy muaj nuk do kishte shumë harxhim nga ana e bashkisë.

**Mitat Daja** . Po a janë dy skrepa?

**Fatmira Thartori** . Janë 3 tani.

**Altin Mema** . Kanalet kulluese kanalet tona atje poshtë si rregull i bie pas 2020 se çdo 5 vjet pastrohen.

**Hekuran Xhani** . Ish drejtori i bujqësisë ka përgjegjësinë që nuk i ka bërë.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje tjetër për z. Altin? Z. Saimir kishe gjë për Gërmenjin? Atëherë z. Altin faleminderit. Kalojmë tek Raport nga sektori i auditit të brendshëm. Fjala për përgjegjësin e auditit të brendshëm z. Nuredin Tosku. Z. Nuredin përshëndetje!

**Nuredin Tosku** . Njësia e auditit të brendshëm ka bërë një auditim për vitin 2023 në Njësinë Administrative Kryevidh. Dhe kemi evidentuar gjetjet dhe kemi dhënë rekomandimet përkatëse të cilat jua kemi dërguar dhe në materialin që keni. Gjetjet kryesisht janë të karakterit organizativ nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të rëndë. Kemi dhënë rekomandimet në bashkëpunim dhe me drejtorinë e taksave jemi përpjekur që të arrijmë një gjëdnje sa më të pastër të të ardhurave nga debitorët normalisht debitorët janë shumë në Njësinë Kryevidh janë 8 miion 947 mijë lekë të reja është një gjëndje që don shikuar patjetër.

**Indrit Dedej** . Janë mbledhur?



**Nuredin Tosku** . Jo janë debitorë.

**Indrit Dedej** . Sa mbledhje keni pasur ?

**Nuredin Tosku** . Mbledhjet mund t'i shohim tani, është për vitin 2021 që e kemi bërë ne auditimin. Këto janë rekomandimet se e kemi thënë të ardhurat sa janë mbledhur 34 milion e 116 mijë e 740 lekë plan fakt realizimi është në 110 %. Dhe për subjektet që janë të peregjistruara kemi dhënë rekomandim që të merren masat, sipas ligjit nr. 9920 për regjistrimin e këtyre subjekteve. Këto janë masat që kemi marrë, N=në qoftë se këni ndonjë pyetje.

**Indrit Dedej** . Masë më ekstreme keni marrë?

**Nuredin Tosku** . Dmth aktualisht jam duke kryer një audit në MZSH-në, unë 1 muaj kam që jam përgjegjës.

**Indrit Dedej** . Ne kemi qejf që t'i shohim gjërat si puna e SPAK-ut.

**Nuredin Tosku** . Ne jemi mbështetës për Bashkinë ne e ndihmojmë Bashkinë, që të arrijë objektivat e saj nuk është se jemi SPAK-u. Ne jemi të brendshëm.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje tjetër për auditin e brendshëm?

**Erind Tosku** . Sa zgjat auditimi i një Njësie?

**Nuredin Tosku** . Varest se sa e parashikon ne e parashikojmë zakonisht 1 muaj, mund të parashikohet edhe më pak në varësi të problematikave që ka njësia.

**Erind Tosku** . Auditimi është i paralajmëruar apo është ...?

**Nuredin Tosku** . Po po dmth krijojmë një plan vjetor dhe një plan strategjik...

**Erind Tosku** . Dmth njoftohet njësia administrative që do ketë...?

**Nuredin Tosku** . Po po ka afatet përkatëse.

**Alime Hoxha** . Dmth ju jepni rekomandimet, pastaj kush merret me këtë?



**Nuredin Tosku** . Njësia na sjell planin e veprimit të rekomandimeve, se mund të ketë dhe rekomandime të cilat nuk pranohen dhe më pas e ndjekim po ne shkojmë për kontroll për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

**Mukades Gixhari** . Pyetje tjetër? Faleminderit. Tani kalojmë tek “Të ndryshme” ku kemi ... projektvendim...

**Enver Memolla** . Kryetare me leje? Në mbledhjen e kaluar jam drejtuar për vendimet e marra nga këshilli bashkiak për periudhën Janar – Tetor sa janë zbatuar dhe sa janë në zbatim sa janë pa zbatuar dhe s’më ka ardhur mund ta di arsyen?

**Ervis Shera** . Rezi mund të na thuash pak për atë vendimin që nuk është konfirmuar. Ai i shpenzimeve të varrimit vetëm ai është që nuk është konfirmuar gjatë periudhës.

**Rezart Vogli** . Nuk është konfirmuar nga ana e Prefekturës se ishte detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 80/2020 i Kryetarit të Bashkisë, kompetencë e kryetarit që të kryeje shpenzimet e varrimit .

**Mukades Gixhari** . Është zgjidhur?

**Enver Memolla** . Për mua kjo nuk është përgjigje.

**Rezart Vogli** . Veri po thotë të gjithë vendimet e këshillit bashkiak ...

**Enver Memolla** . Nuk është përgjigje se pyetja ka qenë shumë e drejtpërdrejtë dhe e qartë më duhet raport sa projektvendime janë marrë, sa janë ekzekutuar sa janë në ekzekutim e sipër sa janë pa ekzekutuar nuk po kërkoj një apo dy. Më duhet numri total, se kam një muaj që e kam kërkuar nuk doja ta thoja në fillim të mbledhjes këtë pjesë por realisht unë këtë e shoh shumë të padrejtë sepse është kërkesë e anëtarit të këshillit bashkiak dhe kryetarit të grupit të PS-së. Siç na kërkojnë projektvendimet që të vijnë këtu, atëherë kjo për mua duket e paprecedentë dhe në vazhden e vazhdimësisë. Dhe diçka tjetër e kam thënë në mbledhjen e dytë të këtij mandate të këshillit bashkiak që të lutem vendimi për të bërë datën, ditën, orën e cakton kolegji i kryetarëve të mbledhjes së këshillit bashkiak.

**Alime Hoxha** . Edhe diçka tjetër, e kemi lënë për komisionin e ekonomisë që të mblidhet të paktën 5 ditë para mbledhjes, ndoshta dhe komisionet e tjera të paktën 5 ditë para mbledhjes.





**Ervis Shra** . 5 ditë para bëhet njoftimi por komisionet mund të mblidhen kur të duan me vullnetin e Kryetares së Komisionit mund të mblidhen.

**Enver Memolla** . Edhe pyetja ishte e drejtpërdrejtë që çdo lloj komisioni do merret vendimi ta marrin kolegji i kryetarëve. Të mblidhen kryetarët e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare kryetari sekretari dhe të vazhdojë historia e kësaj pune. Sepse ndryshe kjo histori tani që ...

**Ervis Shera** . Raporti që kërkoni ju është tek programi i punës që kemi kaluar në Dhjetor dhe vjen çdo fund viti ai. Për Dhjetorin ai është gati dhe kompletohet dmth këtë që kërkoni e ke miratuar njëherë.

**Enver Memolla** . Unë e kërkoj dhe prap.

**Ervis Shera** . Nuk ka problem mund ta kërkojë sa herë të duash.

**Mukades Gixhari** . Për mbledhjen e radhës ...

**Ervis Shera** . Për mbledhjen e radhës vjen.

**Indrit Dedej** . Mund të ketë dhe mbledhje jashtë radhe.

**Mukades Gixhari** . Kemi këtë projektvendimin për komisionin e Integritit Europian. Po ju sjellim një shkresë për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë. Misioni i komisionit të Integritit Europian... Doni të jua lexoj informacionin?

**Fatmira Thartori** . Jo, se e kemi lexuar.

**Mukades Gixhari** . Atëherë fillojmë me komisionin, ju dy kryetarët...

**Enver Memolla** . Kryetare të ndërhyj pak këtu nuk e di do kem apo jo miratimin e Indritit për të bërë komisionin do bëj një mbledhje grupi por meqenëse nuk është i gjithë grupi këtu e lejmë për radhën tjetër këtë pikë. Që të diskutohen dhe grupet të mblidhen të diskutohen mos i vejmë pa qenë prezent personi unë t'i propozoj emrin, ne tre jemi këtu sot. Do bëj një mbledhje grupi mos e bëj me mendimin tim personal.

**Mukades Gixhari** . Jeni dakord z. Indrit ?



**Indrit Dedej** . Dakord jam.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë tek te ndryshme.

**Mitat Daja** . Kisha unë ca gjëra tek të ndryshme, po i them të gjitha përnjëherë që të mos vonohemi shumë se u zgjat dhe shumë mbledhja nu do ju vonoj shumë. Dua përgjigje nga Andi dhe kush është...dua përgjigje konkrete jo burokratike. E përmenda dhe në fillim zona e malësisë lart është situatë emergjente për të rregulluar rrugë për të shkuar njerëzit dhe për të marrë prodhimet. Çfarë zgjidhje do i jepni asaj zone? Një përgjigje do ma japësh tani, apo ditë tjetër me shkrim ku e di unë si do e bësh përgjigjen?

**Andi Proshka** . Ne çdo vit...

**Mitat Daja** . Të lutem mi kurse burokracitë. Ka punonjës mirëmbajtjeje rruga Sinaballaj – Thartor një pyetje po të bëj?

**Andi Proshka** . Nuk po të bëj burokraci. Çdo vit kemi marrë masa...

**Mitat Daja** . Asnjë masë nuk është marrë...

**Andi Proshka** . E ke gabim.

**Mitat Daja** . Po të them unë asnjë masë nuk është marrë po të them unë se unë jam nga malësia nuk jam, çfarë masash ke marrë?! Unë po them mos më jep përgjigje burokratike. Cila rrugë është bërë?

**Andi Proshka** . Tek “Shimtë”.

**Mitat Daja** . E di ku është malësia e Rrogozhinës? -Nga Sinaballaj në Thartor. Lëri “Shimtë” është çështje tjetër.

**Andi Proshka** . E kam fjalën janë marrë masa çdo vit për hapjen e këtyre rrugëve, parcelave.

**Mitat Daja** . Nuk është marrë asnjë masë. Këtë vit ça do bësh?

**Andi Proshka** . Këtë vit sipas problemeve...



**Mitat Daja** . Nuk është problemi nuk kalon dot as me gomar. Çfarë do bëni atje është gjithë ajo zonë. 30 vjet e ka mbajtur pushtet ai i Njësisë Administrative atje dhe nuk ka bërë asnjë gjë.

**Mukades Gixhari** . Ta dëgjojmë deri në fund.

**Mitat Daja** . Është shumë e thjeshtë çdo eskavatorin të hapi rrugën të shkojnë njerëzit të marrin prodhimet.

**Andi Proshka** . Shkojmë ta verifikojmë pastaj të marrim masat çfarë mund të bëjmë.

**Mitat Daja** . Mbledhjen tjetër do më japësh përgjigje çfarë shkresash ke bërë. Tani buxhetin e diskutuam atë punë nuk po e diskutoj më. Atëherë këtu ke një zyrë arsimore që është e Rrogozhinës. Është në varësinë e Bashkisë Rrogozhinë apo në varësinë e Ministrisë së Arsimit? A i paguan qera Bashkisë Rrogozhinë sepse këshilli bashkiak është aksionere në pronat e bashkisë. Pagan qera është pyetje?

**Andi Proshka** . Jo nuk paguan.

**Mitat Daja** . Po si mund të ekzistonkan zyra pa qera këtu?

**Andi Proshka** . Kanë bërë marrëveshje midis palëve, ka qenë hapësira edhe...

**Mitat Daja** . Kush ta lejon ty hapësirën që të fusësh njerëz aty?

**Andi Proshka** . Kush ta ndalon?

**Mitat Daja** . Unë ta ndaloj, se jam këshill bashkiak. Ka qera për këtë?

**Andi Proshka** . Çfarë problemi ka?

**Mitat Daja** . E paguani ju qeranë e merrni e fusni në xhep ose e merr ai e fut në xhep puna e tij. Ka qera apo nuk paguan qera kaq?

**Andi Proshka** . Jo nuk paguan.

**Mitat Daja** . Kush ta lejon ty?



**Andi Proshka** . Me marrëveshje me mirëkuptim ajo zyrë është aty.

**Mitat Daja** . Kjo është pronë e këshillit bashkiak ndërtesa dhe këshilli bashkiak është aksionere në pronat publike dhe ti ke futur në mënyrë klandestine një person dhe një Institucion që nuk duhet të ekzistojë. Ke bërë marrëveshje me shkrim?

**Andi Proshka** . Mbledhjen e ardhshme e diskutojmë të marr dhe unë informacion më tepër për këtë rast.

**Mitat Daja** . Deri tani me çfarë është marrëveshja me shkrim apo me gojë?

**Andi Proshka** . Nuk kam dijeni për këtë gjë, mbledhjen e ardhshme e diskutojmë.

**Mitat Daja** . Është bërë pezullimi i punëtorëve në Bashkinë e Rrogozhinës apo jo? Kam dëgjuar që janë pezulluar një grup punëtorësh për çfarë arsyeje janë pezulluar?

**Andi Proshka** . Bëj një kërkesë që ta shikojmë për mbledhjen e ardhshme.

**Mitat Daja** . Nuk e jep dot arsyen tani?

**Andi Proshka** . Jo.

**Mitat Daja** . Është bërë ngrohja tek shkolla “Qamil Gjuzi” sot nuk ka ngrohje Akoma.

**Andi Proshka** . Po merren masa që do shkollë të ketë sistem ngrohje.

**Mitat Daja** . Këto masa nuk e di çfarë masash po merrni aty nuk ka ngrohje. Kur do bëhet ngrohja me çfarë do ngrohen kalamajtë në shkollë? Është shi, është ftohtë po vjen i ftohti.

**Andi Proshka** . Tani çfarë masash tjera të them unë përveç kësaj që po them.

**Mitat Daja** . Meqë po merren masa e lejmë tek masat e juaja, kaq kisha unë por këto nuk janë përgjigje këto janë përgjigje me kaluar kohën dhe më falni që ju shqetësuam ju administratën.

**Andi Proshka** . Deri mbledhjen e radhës shkolla do jetë me ngrohje.

**Mitat Daja** . Deri tani shkolla është pa ngrohje.



**Altin Tosku** . Unë do isha për një treg fruta perimesh, që është jashtë çdo lloj standart janë të gjithë jashtë.

**Andi Proshka** . Sepse ne mund të kemi hapësira publike...

**Altin Tosku** . Hapësira publike çfarë e bëtë atë ndërmarrjen e punëtorëve, që ishte tregu i fruta perimeve, tani nuk merret vesh më se ku dalin punëtorët se ku është tregu. Tani filluan shirat ku do rri ai, ku do e shesë prodhimin? Leje hapësirën nuk ka gjë lëre hapësirën rregulloje.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit Altin. Znj. Alime çfarë kishe?

**Alime Hoxha** . Përveç asaj që tha Altini për tregun nuk e di që është zënë, unë e di që është tregu i fruta perimeve, që ekziston. Kisha dhe tek pjesa e shkollave për sistemin e ngrohjes, aty tek gjimnazi është një sistem ngrohje kaldaja me naftë por duke qenë se unë e kam ngritur dhe herë tjetër vjet kemi qenë dy shkolla dhe aty ka shumë dëme materiale dhe një nga këto janë kaldajat, ato rrjedhin ujë se janë prishur. Doja që Bashkia të kishim një kontroll për t'i vënë në punë si sistem kaldaje, ka dhe të tjera dëme aty tek ajo shkollë, unë thashë e kam ngritur njëherë por prapë nuk është bërë asgjë...

**Mitat Daja** . As ka për t'u bërë gjë mos ki merak.

**Alime Hoxha** . Si për dyert për sistemin e ndriçimit sepse kemi dhe priza që janë të prishura, ato janë të rrezikshme sepse nxënësit ato janë të rritur nuk kontrollohen mund të shkojnë t'i prekin vetë ato, do isha për një kontroll dhe një rikonstruksion të shkollës. Edhe një gjë tjetër kisha jemi tek pjesa e zënies së hapësirave publike, i kemi tavolinat nëpër trotuare kemi pjesët e trotuareve apo parkingjeve janë të zëna me materialet e dyqaneve që shesin nuk kemi ku kalojmë nuk e di çfarë mase marrim.

**Silvana Aliu** . Nuk mund të japësh në shfrytëzim trotuarin kur ai tre metra është.

**Erind Tosku** . Kisha diçka meqë është drejtori i arsimit në bashki, këto evidencime që sapo foli Mitati, Alimeja i keni evidentuar ju?

**Fatmir Meçaj** . Po, i kemi çuar tek drejtorja e shërbimeve janë në procedura prokurimi flasim për pajisjen tuaj edhe problemet e tjera...

**Mitat Daja** . Po me shkollën “Qamil Gjuzi” çfarë do bëhet?



**Fatmir Meçaj** . Ne për shkollën “Qamil Gjuzi” meqenëse nuk është marrë në dorëzim ne nuk mund të ndërhyjmë dot.

**Mitat Daja** . Çfarë do bëhet pra?

**Fatmir Meçaj** . Kanë problemet e tyre presidenti i firmës me pagesap apo ku e di unë. Na kanë premtuar që do ndërhyjnë brenda kësaj jave.

**Erind Tosku** . Se kjo pjesa të ishin marrë masa paraprakisht...

**Mitat Daja** . Kemi që në Shtator që po themi këtë gjë, që në Shtator është konstatuar problemi i shkollave dhe asgjë nuk është bërë deri më sot. Po të ishte dhe Olsi aty të na tregonte afatet e veta data 16 apo 17 që na dha Olsi.

**Fatmir Meçaj** . Për të qenë i qartë unë e kam parasysh çfarë po ngre, juve na i keni sjellë më shkrim dhe ne i kemi përcjellë dmth e kemi marrë iniciativën që të kryhet procesi i prokurimit.

**Erind Tosku** . Nuk e ve në diskutim nuk e kam tek pjesa e bazës materiale, po flas tek pjesa e problematikave prizave të korentit nuk besoj që duhet procedurë për të rregulluar prizën e shkollës, ndriçimin e gjëra të tjera. Këto janë gjëra si të thuash neglizhencë ose mos kushtim rëndësie, mos i kushtojmë rëndësi i bie që tani që po bie shi dhe errësohet shpejt, të mos kemi ndriçim nëpër shkolla dhe nxënësit ...

**Andi Proshka** . Unë jam në dijeni të problemit këto janë të pajisura me neone që ne nuk kemi gjendje.

**Alime Hoxha** . Janë dhe prizat.

**Andi Proshka** . E kam fjalën për dritat.

**Erind Tosku** . Përveç kësaj, shkollat kanë ngritur edhe kërkesa për festat e 28-29 Nëntorit që shkollat shqyr që po e vitalizojnë Qendrën Kulturore “Haxhi Memolla” tani është për të ardhur keq dhe na vjen zor që nxënësit paguajnë lekë për të marrë ato kostumet me qira apo kostumet popullore për të marrë flamuj për të marrë dekorime. Kështu që nuk ka ndonjë buxhet Bashkia që të japë apo nga kërkesat që vijnë nga shkolla, që t’i japë shkollave që të bëjmë festa më të bukura. T’i angazhojmë nxënësit po i këndojmë himnin javën e parë të çdo muaji. - Dakord, pse



po e heqim atdhetarizmin kur kemi festat se nuk kemi mundësi?! Të paktën bën sens kjo pjesë që t'i vejmë ca gjëra që më përpara se janë fëmijët përpara pastaj jemi ne, kaq kisha.

**Fatmir Meçaj** . Tani sa për tek Pallati i Kulturës janë marrë të gjitha ato kërkesat se po bëhen shumë aktivitete dhe jam dakord me atë pjesën që thoni ju sepse ngelen këto kostumet të bëhen pjesë e Pallatit të Kulturës. Tani në atë vazhdimësi sepse përnjëherë nuk bëhen.

**Alime Hoxha** . Do ishte mirë që jo të themi ne për shkollën por të kishte kostume popullore që të jenë atje.

**Andi Proshka** . Disa vegla muzikore.

**Enver Memolla** . Vetëm Andin kam këtu nuk kam Olsin, kam vënë re që nga reshjet e shumta kohët e fundit rruga e Peqinit ka shumë puseta të bllokuara . Vetë herën e fundit desh jam aksidentuar para fabrikës “Qoshku” ishte pellg me ujë që nuk e pashë realisht nuk e di kush merret emergjencat civile apo shërbimet por realisht është diçka që ...

**Andi Proshka** . Pusetat duan mjete të posaçme që të pastrohen por punëtorët e shërbimit kanë qenë në terren.

**Enver Memolla** . Realisht është problem nuk po kërkoj llogari por duhet të gjeni një zgjidhje për këtë pjesë sepse edhe hyrja në autostradë mban ujë aty. Është një rrezik me makinë je me këmbët e huaja nuk jemi me këbët tona.

**Andi Proshka** . Duhet të jemi të vetëdijshëm që shirat dihet 2-3 orë zgjasin ...

**Enver Memolla** . Jo ato janë të bllokuara unë kam parë që ato janë të bllokuara. Pas shirave të shihen që të mos presim të bllokohen.

**Indrit Dedej** . Ai specialisti të çojë punonjësit se shira të rrëmbyeshëm bien dy herë tre herë.

**Andi Proshka** . Kanë qenë në terren.

**Rezart Vogli** . Unë do flisja për rastin që ngriti zysh Alimeja për shkollën “Haxhi Qehaj” gjimnazin është ngritur grupi i punës nga ana e Bashkisë para 2-3 ditësh është komunikuar me firmën që është marrë me ndërtimin e shkollës është komunikuar me mbikëqyrësin e punimeve besoj që nga dita e Hënë nga dita e Martë do kemi një takim në ambientet e shkollës bashkë me



drejtoreshën e shkollës dhe me mësuesit që kanë ngritur shqetësimin në këshill bashkiak. Duhet të fillojmë patjetër sistemin aty.

**Alime Hoxha** . Sepse aty ka dhe një problem tjetër në një klasë mbushet me ujë sa herë që bie shi. Do kemi një takim shumë shpejt besoj brenda javës që vjen. Për sa i përket Pallatit të Kulturës e kemi thënë dhe vjet në moment që u rikonstrukturova e gjithë Qendra Kulturore ne nisëm me sistemimin dhe krijimin e një klase për muzikën ku me këshillin e shkuar kemi diskutuar që dëshira jonë vazhdonte me sistemimin e atyre dy dhomave me kostumet dhe me pajisjet që do i duhej kësaj Qendre Kulturore në pamundësi për t'i realizuar këto muaj që kaluan them se do i realizojmë shumë shpejt. Dëshira jonë dhe premtimi i Kryetarit të Bashkisë ishte që ajo Qendër Kulturore të kthehet në qendër multifunkionale ashtu siç është ajo klasë aty që ofroi ca kurse profesionale muzike, u krijua dhe biblioteka e qytetit. Ato ambiente që janë të brendshme mundësohet sistemimi bashkë me bazën materiale që janë kostumet popullore apo gjëra tjera artistike që i duhen asaj qendre. Këto kisha faleminderit.

**Silvana Aliu** . A mund të na jepni një datë se kur mbarojnë punimet e shkollës “Qamil Gjuzi”? Keni lënë një makineri aty dhe nxënësit luajnë aty.

**Fatmir Meçaj** . Nuk varet nga ne.

**Andi Proshka** . Ke të drejtë ne një datë nuk japim se e jep firma.

**Silvana Aliu** . Ne drejtori na e dha 8 Nëntorin e quajti të mbaruar.

**Geraldo Gjini** . Ajo siç e dini nuk duhej të futej fare në punë, ajo u bë sepse ishin të dyja shkollat që po u rikonstrukturoheshin njëkohësisht edhe u mor masa sespe firma s’duhet ta lejonte fare që të futeshin nxënësit po ku do rrinin nxënësit. Na toleruan, ne i kemi toleruar pak tek afati.

**Silvana Aliu** . Shkolla tjetër ka mbaruar.

**Geraldo Gjini** . Kishte afatin më të gjatë ajo kishte vetëm rikonstruksion që u bë nga e para. Besoj që ajo brenda këtij viti do jetë e përfunduar.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë meqë nuk kemi më diskutime, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**MBYLLET MBLEDHJA**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 45<sup>oo</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 02 orë ; 29 min ; 01 sek e ndarë në dy video regjistrime konkretisht video e parë 26 min ; 48 sek video e dytë 02 orë ; 02 min ; 13 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 57 (pesëdhjetë e shtatë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**

**Sekretari i Këshillit**

**Ervis Shera**